



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Informatikë Biznesi”
“Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Edlira Martiri

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Shtator /2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bsc në "Informatikë Biznesi"

| | | |
|------|---|--|
| Nr. | | |
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Bujqësor i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Matematikë-Informatikës |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Informatikë Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASh nr. 208 datë 31.05.2013 ¹ |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 586, datë 18.12.2019 ² |
| 6 | Regjistrimi i Formës së diplomës: | Urdhëri i MASR, Nr. 405, datë 08.09.2017 ³ |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 kredite (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | JO |
| 13.1 | • Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | JO |
| 13.2 | • Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | JO |
| 14 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 15 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 23 PAE dhe 1 PAK (96% / 4%) |
| 16 | Numri i studentëve (për tre vite): | 180 Studentë |
| 17 | Komente / të tjera: | (shih shënimet) |

¹ Ky licencim është bërë me emërtimin Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes" me profile": a. *Ekonomiks i Aplikuar*; b. *Informatikë Biznesi*

² Ndryshon pika 1 e urdhërit nr. 208, datë 31.05.2013, dhe 2 profilet hapen si 2 programe të ndryshme Bachelor.

³ Urdhëri për aprovimin e modelit të Diplomës Nr. 405, datë 08.09.2017, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka akoma emërtimin e vjetër të programit: "Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes", profili "Informatikë Biznesi".

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi", është një nga programet e hapura për herë të parë në vitin akademik 2013-2014 në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), në Departamentin e Matematikë-Informatikës (DMI). Hapja e programit është bërë në bazë të Neneve 26 dhe 41 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës.

Licencim: Programi i studimit është hapur me UMASH nr. 208 datë 31.05.2013, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 460 datë 03.05.2013, me emërtimin Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes" me profile": a. *Ekonomiks i Aplikuar*; b. *Informatikë Biznesi*, si program studimi i ciklit të parë, dhe realizohet me 180 kredite me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Ky licencim u mbështet mbi vendimin e Rektoratit, Nr.43 datë 26.12.2012 dhe Senatit, Nr.39 datë 27.12.2012, të cilët konsideruan Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Nr. 13, date 23.11.2012, sipas propozimit të dekanatit të FEAs.

Me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 586, datë 18.12.2019 ndryshon pika 1 e urdhërit nr. 208, datë 31.05.2013, dhe 2 profilet hapen si 2 programe të ndryshme Bachelor.

Akreditimi: Ky program akreditohet për herë të parë

Urdhëri për aprovimin e modelit të Diplomës Nr. 405, datë 08.09.2017, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka akoma emërtimin e vjetër të programit: "Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes", profili "Informatikë Biznesi".

Ky program është rezultat i një procesi të diskutuarit të përbashkët mes personelit akademik, studentëve aktualë dhe të mëparshëm, nevojave të tregut të punës dhe konsultimeve me institucione partnere vendase dhe të huaja. Programi i studimit "Informatikë Biznesi" i specializon të diplomuarit në fushën e ekonomisë dhe informatikës, duke mundësuar kështu një potencial integrimi të tyre në çdo institucion, kompani apo organizatë dhe nga ana tjetër duke iu përgjigjur kërkesave në rritje të biznesit për profesionistë të dy fushave.

FEA dhe DMI janë angazhuar në përmbushjen e të gjitha detyrimeve dhe kritereve në zbatim të bazës ligjore dhe rregulloreve të studimit në fuqi, për mirëadministrimin e programit të studimit. UBT dhe FEA nëpërmjet procedurave transparente të rekrutimit, me objektiv kryesor garantimin e cilësisë, disponon numër të lartë të stafit akademik të kualifikuar që mundëson ecurinë e suksesshme të programit të studimit. Studentët kanë infrastrukturën e nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e orëve të leksioneve, praktikave mësimore dhe punën në grup.

Sigurimi i cilësisë rezulton një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së institucionit. Vlerësimi i fundit i jashtëm, i kryer nga Agjencia Britanike (QAA), në bashkëpunim me ASCAL gjatë vitit akademik 2016, ka përcaktuar pozitën e UBT si një institucion të rankuar mjaft mirë sa i përket cilësisë.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është ngritur me Vendim të Departamentit Matematikë Informatikë, Nr 3 date 04.03.2019, Vendim të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit Nr 20, datë 26.09.2018 "Për miratimin e komisioneve për përgatitjen e dokumentacionit për akreditimin e programeve të studimeve", me Nr. Prot. 261 të datës 02.10.2018 si dhe numër Protokollit të arkivës së UBT Nr 541/1 i datës 07/03/2019. Njësia Kryesore është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Matematikës dhe Informatikës.

Ky raport bën vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të parë të programit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar nga ASCAL, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të parë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi”, e përbërë nga 144 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit “Informatikë Biznesi”, kanë realizuar vizitat në datat 22, 23 Qershor 2020, në Institucionin e Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”.

Koordinator Teknik i vlerësimit të këtij programi është specialisti i ASCAL ME. Renata Qatipi.

Shënim: Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës, është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 24.08.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 13/10 Prot., datë 24.08.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti Bujqësor i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UBT përcjell përgjigjen për Draft-Raportin, me anë të sistemit AMS, me shkresë nr. 254/1 Prot., datë 28.08.2020 të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit “Komente mbi draft raportin e eksperteve të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”.

Në këtë dokument Departamenti ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

1. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 1.2. Kriteri 2.: Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

Komenti i GVJ-së: Sugjerohet vendosja e objektivave në një linjë më të qartë mes dy njëjësive/dokumenteve: “Plani Strategjik i UBT” dhe “Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Informatikë Biznesi”

Komenti i UBT:

Programi i studimit Informatikë Biznesi është një program relativisht i ri, si edhe vetë qasja ndaj teknologjisë në vendin tonë. Në këtë kontekst do sugjerohet përfshirja e teknologjisë së informacionit në fokusin e kërkimit shkencor në Planin Strategjik të UBT_së, Statutin e ri që po punohet dhe Rregulloren e Studimeve Universitare.

FEA është duke punuar aktualisht me strategjinë e kërkimit zhvillimit për periudhën 2021-2030 dhe padyshim ky program është pjesë integrale e zhvillimit dhe vëmendjes si një nga programet me të kërkuara nga studentët dhe nga tregu.

GVJ: GVJ vlerëson përmirësimin e këtij kriteri dhe përfshirjen e teknologjisë në dokumentet e sugjeruara për periudhën 2021-2030.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

2. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 2.1 Kriteri 3: Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

Komenti i GVJ-së: Konstatohet që nuk ka një lëndë që zhvillon mendimin kritik, shkrimin akademik, apo metodat e kërkimit. Pjesa e kërkimit shkencor shihet gjithashtu shumë pak e reflektuar në programet e veçanta lëndore të programit të studimit. Studenti duhet më parë të trajnohet në kryerjen e kërkimit shkencor.

Kjo mungesë bën që Kriteri 4 në këtë Standard të mos jetë i plotë, por vlen të theksojmë që këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor.

Komenti i UBT:

Sikurse e keni përmendur edhe Ju: “vlen të theksojmë që këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor”, dëshirojmë të evidentojmë lëndët të cilat i aftësojnë studentët në përdorimin e metodave bazë të kërkimit shkencor:

1. Statistikë 1
2. Statistikë 2
3. Bazat e ekonometrisë
4. Njohuri mbi informacionin

Modulet synojnë të njohin studentët me një sërë teknikash të cilat përdoren gjatë procesve të kërkimit shkencor. Kjo gjë realizohet edhe me ndihmën e përdorimit të programeve aplikative për vlerësimin, testimin, përzgjedhjen, përdorimin e modeleve ekonometrike për analiza ekonomike. Në nivelin Master zhvillohen module të tjera të cilat thellojnë njohuritë e nevojshme për kërkimin shkencor.

GVJ: GVJ vlerëson saktësimin e bërë nga IAL në lidhje me kriterin. Raporti i plotësuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetet në formulimet e sakta të kriterëve të përcaktuara nga ASCAL, e në rastin konkret kërkohet nga cikli Bachelor që “Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale”. Do kishte qenë me vlerë që këto komente të ishin përfshirë dhe në RVB, pasi kërkimi shkencor duhet të jetë komponent bazë i aktiviteteve të cdo cikli në IAL.

Pavarësisht kësaj, vlerësimi i këtij kriteri ndryshon.

3. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 2.1 Kriteri 6: Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Komenti i GVJ-së : Duke iu referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga IAL, konstatohet që programi i studimit në Informatikë Biznesi i ndan veprimtaritë formuese, lëndët, në disiplina të ndryshme (“Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Informatikë Biznesi”, Neni 8) por në asnjë dokument tjetër nuk gjejmë ndarjen specifike në këto disiplina.

Komenti i UBT:

Departamenti Matematikë dhe Informatikë ka realizuar kategorizimin e lëndëve dhe respektimin e përqindjeve sipas tabelës së veprimtarisë formuese të Shtojcës 1 në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.

Ky kategorizimi është i pasqyruar në programin e lëndës (syllabus) të çdo moduli.

GVJ: Gjatë hartimit të RVJ, kjo vërejtje nuk ka qenë përcaktuese për vlerësimin e standartit, kështu që përmirësimi i tij nuk sjell ndryshim. Në RVJ, vërejtja qëndronte në faktin që ndarjet e lëndëve në kategori specifike nuk janë të përfshira në dokumentacionet e IAL. Rregullorja e FEA, Neni 20, pika 2, cilëson që “Departamentet në rregulloret e tyre të studimeve kategorizojnë fushat disiplinore sipas veprimtarive formuese”. Ndërkohë, ndarja e lëndëve në kategori gjendet në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL si një tabelë e vecantë (“Dosja e plotë e studimit”, f. 6), por jo në Planin mësimor.

Vlerësimi i këtij kriteri ndryshon, pasi konsiderohet nga GVJ si një teknikalitet që mund të rregullohet lehtësisht nga IAL, por nuk ka qenë përcaktues për Standartin.

4. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 2.4 Kriteri 1: Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Komenti i GVJ-së: Në dokumentin Plani Mësimor të programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi” fusha Projekte është e paplotësuar për të tre vitet akademike.

Komenti i UBT:

Tek forma e kontrollit të dijeve në programet e lëndëve, vihet re përfshirja e projekteve të kursit ose/dhe detyrave të kursit nga ana e lektorëve. Gjatë plotësimit të Planit Mësimor nuk i është kushtuar rëndësi ndryshimit të konceptit ndërmjet projektit dhe detyrës së kursit, si dy elementë të veçantë të procesit mësimor. Stafi i DMI-së do të marrë në konsideratë sygjërimet për saktësimin e plotësimit të Planit Mësimor.

GVJ:

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar, pasi IAL do e reflektojë komentin e GVJ në Planin Mësimor të ardhshëm.

5. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 2.4 Kriteri 2: Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.

Komenti i GVJ-së (1) Të dhënat e përgjithshme për secilën lëndë të përputhen me të dhënat e vendosura në kurrikulën e programit të studimit. **(2)** Të shihet mundësia e shkrirjes së lëndëve Probabilitet dhe Statistikë 1 në një lëndë të vetme.

Komenti i UBT:

(1) Ashtu sikurse është theksuar edhe në raportin e GVB në vitin akademik 2017-2018 u miratua një kurrikul e re për programin e studimit Informatikë Biznesi. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është punuar gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe gjatë këtij viti në programin e studimit Informatikë Biznesi zbatoheshin dy kurrikula:

- Kurrikula e vitit akademik 2016-2017 për studentët e kursit të tretë

- Kurrikula e vitit akademik 2017-2018 për studentët e kursit të parë dhe të dytë.

Disa nga programet e lëndëve të cilat janë në dokumentacionin e dorëzuar janë larguar nga kurrikula e re, por janë pjesë e kurrikulës së vjetër. Kalimi në kurrikulën e re ka sjellë pak ndryshime si: spostime të lëndëve në semestra, largim lëndësh dhe riorganizim kreditesh duke respektuar totalin prej 60 kreditesh për sejcilin vit dhe raportin edhe me lëndë të profilit ekonomik në çdo semestër.

Mendojmë që, përfshirja e kurrikulës të vitit akademik 2016-2017 në dokumentat e dorëzuar nga GVB, do kishte qartësuar disa nga komentet e kryera nga GVJ në këtë kriter.

Disa lëndë bazë të detyruara në vitin e parë si rrjedhojë e vendimmarrjes së fakultetit, si dhe viti i tretë vetëm me një semestër mësim, na ka kushtëzuar në shpërndarjen e moduleve nëpër semestra.

Disa nga rekomandimet e sygjera nga GVJ në këtë kriter do përpiqemi ti reflektojmë duke përmirësuar këtë strukturë.

(2) Një ndër arsytet pse Moduli i Probabilitetit nuk është shkruar me Statistikën 1 ka qënë dhënia e një hapësire më të madhe metodave sasore të kërkimit dhe përpunimit të të dhënave.

GVJ: GVJ vlerëson përpjekjen mjaft serioze të IAL në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. Kjo është një praktikë e domosdoshme, vecanërisht për profilet e teknologjisë, të cilët ndryshojnë shumë shpejt. Në lidhje me diskutimin e GVJ për modulën e Probabilitetit, ai mbetet në kuadrin e një sugjerimi, me qëllim dhe krijimin e hapsirave për lëndë dhe module të tjera, por ky është një vendim që i mbetet IAL.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar, pasi GVJ ka vlerësuar mbi dokumentacionin e dorëzuar nga IAL (që një pjesë mund të ketë qënë e papërditësuar), por gjatë vizitës janë kërkuar dokumente të reja dhe vlerësimin e kemi përshtatur sipas tyre .

6. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 2.4 Kriteri 4

Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Komenti i GVJ-së

Nevojitet të theksohet më shumë mendimi kritik nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ngritjes së hipotezave, matjeve, eksperimenteve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe parashtrimit të rezultateve. Kjo është pjesa që mungon në programin e studimit Bsc në "Informatikë Biznesi", pjesë që në fakt është e rëndësishme në programe të ngjashme ndërkombëtare.

Komenti i UBT:

Ashtu sikurse kemi theksuar më sipër, metodat sasore të kërkimit shkencor gjejnë hapësirë të mjaftueshme në programin e studimit Informatikë Biznesi në nivel Bachelor. "Ngritja e hipotezave, matjeve, eksperimenteve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe parashtrimit të rezultateve" – trajtohen në modulet e mbuluara nga lektorët e statistikës dhe ekonometrisë.

Kërkimi cilësor vlerësohet më i nevojshëm për studentë në nivelin master, duke marrë parasysh edhe faktin që ky program studimi trajton dy disiplina të gjëra "Informatikë" dhe "Ekonomi", të cilat kanë nevojë për hapësirë në strukturën e kurrikulës.

GVJ:

Vlerësimi i këtij kriteri ndryshon.

7. Paragrafi në draft RVJ

Standardi 2.4 Kriteri 7: Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.

Komenti i GVJ-së: GVJ sugjeron që ky program të orientohet pak më tepër drejt Agrobiznesit në mënyrë që të shfrytëzojë burimet njerëzore, infrastrukturën ekzistuese, mjediset e përbashkëta ku mund të zhvillohen projekte kërkimore apo detyra të natyrave të ndryshme në terren.

Komenti i UBT:

Është diskutuar në nivel ndërfaqultetor përmirësimi i programit të disa lëndëve si një zgjidhje për ndërthurjen e fushës së Agrobiznesit me Teknologjinë e Informacionit. Përfshirja e rasteve të studimit dhe temave për përdorimin e teknologjive të reja në bujqësi në disa module, si dhe pasurimi i materialeve didaktike të lëndëve aplikative të programit tonë me shembuj nga fusha e bujqësisë, mendojmë që do të sjellë një përmirësim në aftësitë profesionale të studentve në drejtim të Agrobiznesit.

Këto iniciativa do të merren edhe në kuadër të përfshirjes së disa anëtarëve të stafit akademik në projektet e financuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe FAO për dixhitalizimin e bujqësisë në Shqipëri.

GVJ:

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar, pasi është një vendim që pritet të ndodhë.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Biznesi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | |
| Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | GVJ arrin në përfundimin se Programi i studimit “Informatikë Biznesi”, ofruar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to. Madje, Informatika apo degë të ngjashme, janë sugjeruar si ndër profesionet më të kërkuara nga organizma të ndryshëm. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm përcjell dhe faktin që <i>bujqësia dixhitale konsiderohet si ndër fushat zhvillimore më të rëndësishme apo subjekt i projekteve të ndryshme europiane</i> . Për të dyja këto arsye, UBT dhe njësia bazë kanë vendosur hapjen e degës “Informatikë Biznesi”. | | | |
| Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi Bsc në “Informatikë Biznesi” ndjek vizionin e shprehur në dokumentin “Plani Strategjik i Menaxhimit të UBT 2016-2025”, sipas të cilit IAL synon të ndërthurë edukimin me kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive. Në të njëjtin dokument, pika 6.2, shihet e përfshirë në strategjinë e institucionit dhe kryerja e aktiviteteve ndërkulturore jashtë kurrikulës. | | | |
| Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Në dokumentin “Rregullorja e Studimeve Universitare” e UBT, nëni 19 konfirmohet që programet e studimit të ciklit të parë, ndër të cilët dhe “Informatika e Biznesit”, ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e UBT si dhe Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tij, në përputhje me strategjinë për zhvillim të UBT-së. | | | |
| Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Sipas RVB, institucioni ka kryer analiza si dhe ka hulumtuar studime zyrtare të organizatave shtetërore dhe private, vendase dhe të huaja, si dhe nga nevojat e bizneseve me të cilët UBT ka komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Rezultat i kësaj analize ishte dhe hartimi i programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi”. Meqënëse, profesionistët e rinj që përfundojnë studimet në këtë program kanë natyrë ndërdisiplinare, ata mund të themi që integrohen mirë në sektorë të ndryshëm duke kontribuar kështu dhe në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij. | |
|--|-------------------------------|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| | |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> | <p>IAL e shpreh qartë në dokumentin “Rregullorja e Studimeve Universitare në Kreu IV, Neni 19, që institucioni ofron programin e studimit në përputhje me strategjinë për zhvillim të UBT-së. GVJ e konstaton këtë dhe në bazë të përmbajtjes së programit të studimit, sipas të cilit një i diplomuar në “Informatikë Biznesi” ndërthur drejtimin e Informatikës me atë të Ekonomisë/Biznesit.</p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> | <p>Në dokumentin “Plani Strategjik i UBT” specifikohen drejtimet prioritare të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Sipas tij, FEA ka pasur si focus të kërkimit shkencor fushat e mëposhtme: <i>Strategjitë dhe politikat e zhvillimit rural të integruar</i>. • <i>Zhvillimet rajonale dhe politikat e integritit rajonal dhe ndër-rajonal</i>. • <i>Politikat bujqësore dhe analiza e vlerësimit i tyre</i>. • <i>Strategjitë e menaxhimit të inputeve dhe outputeve në bujqësi</i>. • <i>Strategjitë dhe politikat e menaxhimit të agrobiznesit</i>. • <i>Strategjitë dhe politikat e integritit të fermerëve në tregje</i>. • <i>Probleme të menaxhimit & marketingut në zinxhirin e vlerësimit</i>. • <i>Strategjitë dhe politikat e financimit të sipërmarrjeve private në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të tyre</i>. • <i>Strategjitë dhe politikat e zhvillimit të turizmit rural</i>.</p> <p>Ndërkohë në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Informatikë Biznesi”, neni 1, shihet që programi i studimit synon kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e ekonomisë dhe informatikës; përgatitjen e specialistëve të aftë për zgjidhjen e problemeve teknike në fushat e ekonomisë, menaxhimit, informatikës dhe programimit. Sugjerohet vendosja e objektivave në një linjë më të qartë mes dy njësive/dokumenteve.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p> | <p>Programi i Studimit Bsc në “Informatikë Biznesi”, është një program që përmbush vizionin aktual të UBT, të përcaktuar në statutin e UBT dhe planin strategjik, por dallohet që konteksti bujqësor/blegtoral/agrokulturor në përgjithësi është me peshë më të vogël në përmbajtjen e programit të studimit. Kjo u konfirmua dhe gjatë vizitës në IAL në takimin me studentët dhe stafin.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X | |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p> | <p>Në këtë kriter, grupi i punës që ka realizuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, ka konsideruar objektivat në modulet dhe programet lëndore të tyre, si dhe ka analizuar koherencën e çdo moduli me profilin e programit, por jo atë të programit të studimit në Bsc në “Informatikë Biznesi” në përgjithësi. GVJ rishqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga IAL për të parë plotësimin e Kriteri 1, Standardi I.3. Vlerësojmë që për këtë kriter IAL shprehet në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Informatikë Biznesi”, Kreu I, Neni 1, pika d</p> |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| | <p>(synimet profesionale), pika e (aftësitë), pika f (synime të analogjisë me struktura jashtë vendit), por në mënyrë mjaft të shkurtër.</p> <p>Këto pika sugjerojmë që të detajohen më qartë dhe të plotësohen më tej, ose të përditësohet sipas dokumentit “Studim tregu për hapjen e programit Bsc në Informatikë Biznesi dhe në vazhdim për përmirësimin e kurrikules”, viti 2012, ose “Suplementi i diplomës”, ku këto informacione janë të plota.</p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>IAL përmban në strukturën e vet administrative disa njësi të rëndësishme, të cilat kanë funksionalitete të ndryshme në ndihmë të përmirësimit të marrëdhënieve të tij me tregun e punës. Kështu, GVJ konstaton që një prej tyre është Zyra e Marrëdhënieve me Biznesin (ZMB), një nga përgjegjësitë e së cilës është “...rritja e profesionalizmit dhe orientimit të kurrikulave të studimeve sipas tregut të punës...”. Një njësi tjetër është Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila ka në përbërje të saj: koordinatorin e qendrës, Bordi Ekzekutiv i Alumni, dhe student të angazhuar vullnetarisht. Në dokumentin “Rregullore mbi Organizimin dhe Funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerëzimit Institucioal”, konstatohet që “...objekti i veprimtarisë së QKA përfshin; Sigurimin e informacioneve dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës së studentëve duke shërbyer si një nyje ndërlidhëse midis studentëve të UBT”. Bazuar në Neni 41 të po këtij dokumenti mbi Funksionalitetet dhe përgjegjësitë e QKA, si dhe të RVB, mendojmë që ky kriter plotësohet në të gjithë elementët e tij përveç studimit të tregut ndërkombëtar.</p> <p>Sikurse vumë në pah në kriterin 1, duhen ripërpunuar objektivat formues, ndërkohë që struktura e programit “Informatikë Biznesi” ka një përmbajtje të përshtatshme me nevojat e tregut të punës.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X | |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p> | <p>Sipas RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ofron rreth 14 programe studimi nga të cilat 6 programe të ciklit Bachelor, 5 programe të ciklit Master Profesional dhe 3 Master Shkencor. Në shërbim të këtyre programeve janë aktiv rreth 93 pedagogë staf akademik me kohë të plotë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 15 Prof. Dr. - 28 Prof. Asoc. - 33 Dr. - 15 Msc. |

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| | <p>Nga ana tjetër FEA disponon rreth 48 salla mësimi, 9 prej të cilave me kapacitet mbi 150 vende dhe 7 me kapacitet nga 52 deri në 80 vende. Janë në shërbim të punës praktike të studentëve 6 laboratorë, dy prej të cilëve me rreth 25 kompjutera në secilin prej tyre janë krijuar së fundmi në funksion të Programit të Studimit “Informatikë Biznesi”. FEA si njësi kryesore, falë departamenteve të tjera pjesë strukturore e FEA, ofron studimet e larta në nivelin 6, 7 dhe 8 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. DMI është pjesë e njësisë kryesore dhe përgjegjëse FEA, e cila ofron programe studimi në të tre ciklet në fushën e shkencave të ekonomisë bujqësore.</p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>UBT është në proces të kodifikimit të programeve të studimit për të gjithë Fakultetet bazuar në LAL 80/2015 neni 86. Programi i studimit i Informatikë Biznesi është program i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale është tri vite akademike.</p> <p>GVJ konstaton që fusha e programit të studimit në Bsc në “Informatikë Biznesi” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, por sugjerojmë një përfshirje dhe shkrirje dhe në nivel lëndor të disiplinave: Informatikë, Ekonomi, Agrobiznes, apo të disiplinave të ngjashme që janë në varësi të Fakultetit.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Në RVB pohohet që programi i studimit “Informatikë Biznesi” është konceptuar dhe hartuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore specifike të departamentit Matematikë Informatikë që është: “Informatikë Biznesi” dhe fushën e përgjithshme të fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit që është <i>ekonomia bujqësore</i>.</p> <p>Në Planin Mësimor të programit të studimit, vëmë re që studentët që mbarojnë këtë program ndjekin gjatë vitit të parë 12 lëndë, nga të cilat 2 prej tyre janë të orientuara nga ekonomia bujqësore, saktësisht: “Prodhim bimor” dhe “Prodhim shtazor”. Në vitin e dytë, gjendet vetëm një lëndë me zgjedhje e kësaj natyre, përkatësisht “Drejtimi i fermave”. Në vitin e tretë nuk gjendet asnjë lëndë e orientuar nga Agrobiznesi apo Ekonomia bujqësore.</p> <p>Në përmbajtje të programeve lëndore (syllabus), vëmë re që në pjesën e tyre më të madhe lëndët me formim të përgjithshëm (p.sh. Anglisht, Matematikë, etj) janë të pakontekstualizuara me Agrobiznesin (në formën e rasteve të studimit, në objektivat e tyre, në komentet e lektorëve për lëndët, apo në tematikat e veçanta të çdo jave), lëndët e profilit Ekonomi (p.sh. Mikroekonomi, etj) janë të paintegruara me çështje të IT, si dhe lëndët e IT janë të pazbatuara në fushën e Agrobiznesit. Sugjerojmë një rishikim të programeve lëndore nën këtë filozofi, pra atë të integritimit të disiplinave të programit të studimit edhe në nivel syllabusi.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X | |

| Standardi I.5 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që IAL i jep rëndësi të veçantë analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Kështu, shohim së në këto analiza në vëmendje të tyre janë: Programet e studimit; Procesi mësimor; Stafit akademik; Studentët; Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm; dhe Veprimtaria ndihmëse. Gjithashtu, sipas RVB, shihet që FEA realizon çdo vit vlerësimin e ecurisë së Programeve të Studimit, bazuar në Indikatorët themelorë: Kurrikula e Studimeve, Planet Mësimore dhe Programet mësimore të cdo moduli. Hartimi dhe modifikimi i secilit prej tyre është përgjegjësi e Njesisë Bazë e cila organizon procesin me angazhimin e stafit akademik të GKM-ve të saj, apo të njësisve të tjera bazë që janë të angazhuara në këtë program studimi. Analiza synon të evidentojë arritjet dhe problematikat me synim rishikimin e objektivave për përmirësimin e vazhdueshëm të ecurisë së Programit të Studimit dhe procesit mësimor në tërësi.</p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p> | <p>Gjatë vizitës në IAL, si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuar GVJ konstaton që UBT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe homologesh ndërkombëtare dhe vendas në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve. Sipas RVB, rreth 100 studentë të gjithë Fakulteteve të UBT bëhen çdo vit pjesë e programeve të shkëmbimit me universitete dhe organizata të huaja në kuadër të programeve ERASMUS+, CEEPUS, etj.</p> |
| <p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> | <p>Konkretisht, në dokumentin “Marrëveshjet e bashkëpunimit (active) me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët vendas dhe/ose të huaj” janë listuar 44 IAL me të cilat UBT ka marrëveshje, nga të cilat 30 janë të huaja dhe 14 nga universitete nga Shqipëria dhe Kosova. Në të njëjtin document gjenden dhe 14 institucione dhe fondacione më së shumti shqiptare si Ministritë, Kuvendi i Shqipërisë, AKSH, Dhoma Britanike e Tregtisë, etj, si dhe 43 sipërmarrje me të cilat UBT ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi, në kuadër të mundësive për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët e UBT.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> | <p>Një nga arritjet më të rëndësishme të UBT nga këto marrëveshje bashkëpunimi është dhe themelimi i qendrës innovative të shkencës dhe teknologjisë bujqësore Kinë-Shqipëri (gjendet në dokumentin “Përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit”).</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit mban evidenca të përvitshme të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në terma të numrit të praktikave profesionale apo mobiliteteve të realizuara.</p> |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> | <p>UBT ofron për studentët e programit “Informatikë Biznesi”, apo të të gjithë degëve të tjera që duan të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e Programimit dhe Përpunimit të të dhënave, një numër kurseesh të informatikës. Këto kurse u drejtohen dhe nxënësve të shkollave të mesme të Tiranës dhe rrethinave të saj.</p> <p>Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit si dhe Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit kanë siguruar infrastrukturën e nevojshme për të siguruar formimin teorik dhe atë praktik të pjesëmarrësve në këto kurse. Për realizimin e këtij programi egzistojnë të gjitha modalitetet e nevojshme të tilla si sipërfaqja në dispozicion, sallat për zhvillimin e leksioneve, sallat për zhvillimin e seminareve etj.</p> <p>Në dokumentin “Program për formimin profesional të specialistëve në fushën e Informatikës” (2017) propozohen modulet: Programim në Python, Java, C++, C, Linux, Paketa Office, SPSS. Secili kurs zgjat 15 javë, është 5 ECTS dhe në fund pjesëmarrësit pajisen me çertifikatën përkatëse. Numri i studentëve në këto kurse varion nga 20 deri në 40.</p> <p>GVJ saktëson që këto kualifikime janë mjaft të rëndësishme për studentët e UBT në përgjithësi dhe gjithashtu vlerësojmë përzgjedhjen e temave të tyre si ndër aftësitë më të kërkuara sot në tregun e punës.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | | | | |
|---|------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> | |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| | |
|---|--|
| <p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që programi i studimit “Informatikë Biznesi” është organizuar në lëndë, të cilat vlerësohen me kredite në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në bazë të Rregullores së Fakultetit, lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese. Struktura dhe përmbajtja e programeve mësimore është në përshtatje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Programi i studimit “Informatikë Biznesi” përmban 180 ECTS dhe është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra), ku cdo vit akademik ka 60 ECTS.</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> | <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson programin e studimit “Informatikë Biznesi” si një profil mjaft të domosdoshëm në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit. Struktura mësimore e programit përmban lëndë të cilat lejojnë që në fund të programit të studimit, të diplomuarit të mund të orientohen/punësohen në një larmi profesionale. Pavarësisht kësaj, GVJ nuk i gjen këto konkluzione mjaft të rëndësishme për programin e studimit në një sërë dokumentesh si: “Statuti i UBT”, “Plani Strategjik i UBT”, “Rregullore e Studimeve Universitare”, “Rregullore e programit të studimeve bachelor në Informatikë Biznesi”, etj. Në “Suplementin e Diplomës” ky informacion gjendet, por jo në ato të sipërpërmendura.</p> |
| <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> | <p>Gjatë vizitës në IAL, në bazë të RVB, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton që programi Bsc në “Informatikë Biznesi” pasqyron në planin mësimor disiplina mësimore bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Në vitin e parë të studimeve studenti përvetëson njohuri të përgjithshme dhe formuese (si Matematikë, Sociologji, Anglisht), lëndë bazike informatike (Hyrje në informatikë, Algoritmikë dhe Strukturë të dhënash), lëndë të Ekonomisë (si Mikro/Makroekonomi), si dhe lëndë të disiplinës së Agrobiznesit (si Prodhim Bimor/Shtazor). Në fund të vitit të parë një student i programit “Informatikë Biznesi” ka marrë njohuri të fushave nga më të ndryshmet në nivel bazik.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Në vitin e dytë të studimeve vihet re një vazhdim i trendit të vitit të parë, ku nga 12 lëndë, kemi këtë kategorizim: 5 lëndë informatike, 4 lëndë ekonomike, 2 të përgjithshme, si dhe 1 lëndë është me zgjedhje. Në fund të këtij viti studenti ka thelluar njohuritë e tij sidomos në disa prej shtyllave kryesore të Informatikës si Programimi, Databaza dhe Rrjetat.</p> <p>Viti i tretë i studimeve përmban 7 lëndë, praktikën profesionale dhe tezën bachelor. Nga 7 lëndët 3 janë të fushës së Informatikës, 2 janë me zgjedhje, 2 janë të Ekonomisë. Në përfundim të vitit të tretë studenti duhet të ketë përvetësuar dhe çështje më komplekse teknike, ashtu si edhe koncepte më të avancuara ekonomike.</p> <p>Konstatohet që nuk ka një lëndë të veçantë që zhvillon mendimin kritik, shkrimin akademik, apo metodologjinë e kërkimit. Elementë të rëndësishëm të metodave të kërkimit shkencor janë përfshirë në lëndët Statistikë 1 e 2, dhe Ekonometri.</p> <p>Nga ana tjetër vlerësojmë nxitjen e IAL për pjesëmarrje të studentëve në konferenca.</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> | <p>Sipas RVB, referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, programi i studimit në “Informatikë Biznesi” plotëson të gjithë elementët për një strukturë korrekte dhe bashkëkohore. Programi i studimit është i ndarë në module të mirëfillta të cilët nuk kanë mbivendosje midis tyre dhe janë me karakter formues dhe profesional. Çdo modul ka të specifikuar qartë kreditet (ECTS) në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë.</p> |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Duke iu referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga IAL, konstatojmë që programi i studimit në Informatikë Biznesi i ndan veprimtaritë formuese, lëndët, në disiplina të ndryshme (“Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Informatikë Biznesi”, Neni 8) por në asnjë dokument tjetër nuk gjejmë ndarjen specifike në këto disiplina. Në RVB gjejmë vlerat në përqindje, <i>kështu rreth 16 % e tyre janë në veprimtari bazë përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme përkundrejt 52% në disiplina karakterizuese përgatitje për disiplinën shkencore që lidhen me fushën, 14% ka të bëjë me veprimtari formuese integrale nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje, 12% lëndë plotësuese, gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale dhe 5 % detyrime përmbyllëse, përgatitja e tezës.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> | |

| <p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p> | |
|---|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015, Neni 23) si njësi akademike kryesore bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, miraton kriteret e pranimit të studentëve mbi bazë të propozimeve të kryera nga njësi bazë. FEA ka në përbërje të tij 6 (gjashtë) departamente përkatësisht: Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit, Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural, Departamenti i Financë Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Secili prej departamenteve është përgjegjës për zhvillimin normal të procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, përgjegjës për grupet mësimore dhe shkencore, përzgjedhin fituesit e programit të studimit. Departamenti Matematikë Informatikë, referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015 (neni 14, 15), përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin nga ASCAL.</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p> | <p>IAL ka përcaktuar një nga anëtarët e stafit efektiv për të qenë koordinor i programit Bsc në “Informatikë Biznesi” që kur ky program do të hapet. Më pas anëtari ka kaluar si përgjegjës i Grupit Mësimor Kërkimor të Informatikës dhe njëkohësisht përgjegjëse e Zyrës së Kurrikulave dhe Mësimit në Rektorat, duke ia lënë vendin e koordinorit përgjegjës të departamentit. Përgjegjësi i departamentit të Matematikë Informatikës përgatit dhe propozon kurrikulat e studimeve të Departamentit (në bashkëpunim me stafin akademik të programit IB), ndikon në mbarëvajtjen e punëve të grupeve mësimore e kërkimore dhe realizon bashkëveprimin ndërmjet grupeve rënësirorë e kërkimorë (nëse ka më shumë se një). Ai gjithashtu kujdeset për mbarëvajtjen e praktikave profesionale si dhe informon titullarin në lidhje me proceset apo</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | problematikat e punës. | | | |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Departamenti Matematikë Informatikë është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit “Informatikë Biznesi. Ai gjithashtu është përgjegjës për propozimin e kriterëve pranues të studentëve në programin e studimit Bsc në “Informatikë Biznesi”, kriterë të cilat miratohen dhe nga njësia kryesore FEA. | | | |
| Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Ky departament përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore, po ashtu edhe Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit plotëson të gjitha kriteret për shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Gjatë këtyre viteve UBT dhe FEA i është nënshtruar disa ndryshimeve të cilat kanë pasur për qëllim konsolidimin dhe rritjen e cilësisë si në aspektin e kualitetit të stafit akademik mësimdhënës ashtu edhe të programeve të studimit, diplomave dhe kurrikulave përkatëse dhe drejtimit. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës është i ndarë në 2 grupe mësimore-kërkimore: | | | |
| Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | <ul style="list-style-type: none"> - Matematikë: ka në përbërje 7 punonjës staf akademik me kohë të plotë, me një strukturë titujsh si më poshtë: - Informatikë: ka në përbërje 7 punonjës staf akademik me kohë të plotë, me një strukturë titujsh si më poshtë: <p>Pra, pjesa më e madhe e stafit të angazhuar e që mbulon këtë program studimi janë staf i njësisë kryesore përgjegjëse për programin ndërkohë që angazhimi i stafit nga njësitë e tjera mbulon drejtime të përafërta me një sërë disiplinash të tjera që ofrohen në kuadrin e programeve të tjera të studimit të FEA në të dy nivelet Bachelor dhe Master, duke garantuar një balancë të mirë mes specializimit, ndërdisiplinaritetit dhe kërkimit.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi II.3 | |
| Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti i Matematikës dhe Informatikës disponon gjithë informacionin e nevojshëm elementet e programit të studimit Bsc në Informatikë Biznesi siç janë struktura e vitit akademik, kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, kurrikula dhe plani mesimor, mënyra e vlerësimit të studentëve, praktika profesionale dhe diplomimi. Rregullorja e njësisë kryesore FEA bën përcaktimin e standarteve në lidhje me përgatitjen, organizimin dhe administrimin e studimeve universitare. Gjithashtu, bazuar në këtë rregullore, Dekani miraton rregulloret e programeve të studimit të njësive bazë. |
| Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore | GVJ konstaton se programi i studimit Bsc në “Informatikë Biznesi” organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Këto të dhëna detajohen në rregulloren e |

| | |
|---|---|
| në fuqi. | programit të studimit, si dhe pasqyrohen në të dhëna të ndryshme tabelare në dokumentacionin e dorëzuar. |
| Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Programi i studimit është i ndarë në 3 vite akademike, 6 semestra, me 180 ECTS në total, ku mesatarisht çdo semestër ka një ngarkesë prej 24 orësh në auditor. |
| Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | RVJ konstaton që dokumenti “Plani mësimor” i programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi” përmban një pjesë të rëndësishme të informacionit në lidhje me orët mësimore të çdo lënde përgjatë tre viteve të studimit; numri i ECTS, raporti leksion/seminar, detyrimet e modulit, vlerësimi i studentit, si dhe mënyra e zhvillimit të provimit. Çdo lëndë vlerësohet 40% gjatë vitit dhe 60% në provimin final (përfshijtur 3 lëndë teknike ku raporti është 50% - 50%). Në programin mësimor vërehet që mungojnë orët e dedikuara të laboratorit, por nga kontrolli i syllabueseve, nga vizita në institucion, si dhe nga takimi me studentët konfirmohet kryerja e punëve praktike në laboratorë gjatë orëve të seminarit. Por, nga ana tjetër, në dokumentin “Rregullore e programit të studimit”, Neni 14, pika b, gjejmë që “...frekuentimi i orëve laboratorike është i detyrueshëm në masën 100%”. |
| Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Rregullat për frekuentimin si dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe në programet e vecanta lëndore, si dhe në dokumentin e sipërcituar. Ato ndjekin Rregulloren e UBT. Neni 7 i këtij dokumenti saktëson dhe procesin e transferimeve të studentëve që vijnë në programin e studimit “Informatikë Biznesi”. Ky kalim konsiderohet i vlefshëm kur departamenti të ketë njohur plotësisht ose pjesërisht kreditet e grumbulluara nga studenti. Në Statutin e UBT, neni 55, përcaktohen dhe hapat përsa i përket procesit të njohjes së studimeve. Këto kritere janë përgjegjësi e departamenteve, saktësisht nga Komisioni i Ekuivalentimit të ngritur nga departamenti. Për DMI, në rregulloren e tij, nuk cilësohet ndonjë kriter për njohjen e krediteve në procesin e transferimit, por në Rregulloren e Studimeve Universitare, Kreu X, departamentet orientohen për ndjekjen e procedurave, pasi ky kre i dedikohet tërësisht Transferimit, Njohjes së Krediteve dhe Ekuivalentimit. |
| Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Në RVB si dhe në dokumentacionin e dorëzuar, konfirmohet që për programin e studimit Bsc në Informatikë Biznesi çdo fillim viti akademik hartohet dosja e plotë e këtij programi studimi e cila përmban syllabuset për secilën lëndë, kurrikulën, planin mësimor, ngarkesën e plotë të stafit akademik, strukturën e vitit akademik etj. Syllabusi përmban gjithë informacionin e nevojshëm për secilën lëndë që ofron programi në çdo semestër studimi referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018. Programet lëndore ndjekin të gjithë të njëjtin format. Syllabuset e detajuara për çdo lëndë janë dhe të aksesueshme online në ueb-site-n personal të stafit akademik përgjegjës për modulin. Ato janë të plota dhe ofrojnë informacion të detajuar mbi: të dhënat të përgjithshme të lëndës, qëllimi dhe objektivat, kalendari i temave, forma e vlerësimit, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar etj. |
| Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në | GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësive bazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm, në fillim të çdo viti akademik. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile teknike si ai i programit të studimit në “Informatikë Biznesi”. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi II.4 | |
| Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | GVJ evidentoi që ngarkesa e programit të studimit në programin “Informatikë Biznesi”, prej 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademik është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me raportet mes orëve të leksioneve dhe seminareve, GVJ konstaton që ato ruhen në mënyrë të kënaqshme. Në dokumentin Plani Mësimor të programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi” fusha Projekte është e paplotësuar për të tre vitet akademike. |
| Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve të tyre, të shpërndarjes së lëndëve dhe përmbajtjes së tyre, sugjeron që: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat e përgjithshme për secilën lëndë të përputhen me të dhënat e vendosura në kurrikulën e programit të studimit (p.sh. numri i ECTS, forma e vlerësimit, etj). Në krye të çdo syllabusi tek fusha “Ngarkesa” të vendoset emërtimi ECTS (p.sh. Ngarkesa: 7 (shtatë) të zëvendësohet me: Ngarkesa: 7 ECTS) 2. Të shihet mundësia e shkrirjes së lëndëve Probabilitet dhe Statistikë 1 në një lëndë të vetme. 3. Lënda “Bazat e Agrobiznesit” nuk është e reflektuar në kurrikulën e programit, por në syllabus konfirmohet që zhvillohet në vitin II në “Informatikë Biznesi”. 4. Të shihet mundësia për të shtuar një lëndë “Shkrim Akademik”/”Metoda kërkimi” për të plotësuar aftësitë kërkimore të studentëve. Mund të zëvendësojë lëndën “Sociologji” ose një nga lëndët me zgjedhje të vitit të tretë. 5. Lëndët “Hyryje në Informatikë” dhe “Algoritmikë e Strukturë të dhënash” mësojnë të dyja gjuhën C (ndërsa tek konceptet kryesore cilësohet si C++, por edhe kjo gjuhë mësohet në vit të tretë). Të bëhet ndarje më e qartë e këtyre dy lëndëve në përmbajtjen e tyre. 6. Emërtimi i lëndës “Database dhe Menaxhimi” nuk është i plotë dhe |

| | |
|--|---|
| | <p>nuk mund të qëndrojë (menaxhimi i kujt?)</p> <ol style="list-style-type: none"> 7. Lëndëve “Mikroekonomi I” dhe “Makroekonomi I” t’u hiqet numri nga emërtimi, pasi këto lëndë ofrohen vetëm një herë në programin e studimit (pra, nuk gjejmë Mikroekonomi II). 8. Lëndët “Programim në Internet” dhe “ASP.NET dhe C#” nuk mund të qëndrojnë në të njëjtin semestër. Sugjerojmë që “Programim në Internet” të zhvendoset një semestër më përpara, pasi një student nuk mund të kuptojë modelin MVC, pa dikur se cilët janë gjuhët dhe komponentët e tjerë të stack-ut të uebit (HTML, CSS, Javascript, etj). Lëndët kanë prerje pjesën e Ajax, sipas programeve lëndore, si dhe në ASP.Net literaturat janë pa vitet e botimit. Këshillojmë që faqja e e3school të sugjerohet në klase si material ndihmës, por të mos vendoset si literaturë në syllabus, pasi nuk është e tillë. 9. Për lëndën “Manaxhim i Teknologjisë së Informacion”, nuk përputhet emërtimi me përmbajtjen e syllabusit. Ky emërtim vlen vetëm për temën e parë, ndërkohe që temat e tjera janë “Arkitekturë kompjuteri” dhe më së shumti “Rrjeta kompjuterike”. Në këtë lëndë mungon viti i botimit të literaturës kryesore. Së fundmi, sugjerojmë që lënda të mos qëndrojë në të njëjtin semestër me “Sisteme shfrytëzimi”, pasi janë lëndë që plotësojnë njëra tjetren (rrjedha më e mirë logjike do ishte: Arkitekturë – Sisteme shfrytëzimi – Rrjeta). 10. Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL gjendet lënda “Menaxhimi i cilësisë”, që nuk është në programin mësimor të Bsc në “Informatikë Biznesi”. Ndodhet gjithashtu tepër “Bazat e se drejtes” dhe “Drejtimit financiar”, si dhe mungojnë syllabuset e lëndëve “Matematikë e Zbatuar” dhe “Gjuhë e huaj 2”. 11. Lënda “Modelim Biznesi” në përmbajtje të saj është “Inxhinjerim softuerësh”. Sugjerojmë të ndryshohet emërtimi i lëndës. 12. Emërtimi i lëndës “Aplikim Programesh” nuk qëndron, por sugjerojmë të përshtatet me përmbajtjen e saj. Në të mësohen dy gjuhë të reja programimi: Visual Basic dhe C++. Nuk është e qartë për GVJ arsyeja e vendosjes së gjuhëve të kësaj natyre procedurale në semestrin e fundit të studimeve, kur në të njëjtën kohë studenti po përvetëson dhe tre gjuhë të tjera të uebit. Sugjerojmë që kjo lëndë të shkrihet me lëndën “Programim” ose të zhvendoset në semestrat e tjerë. 13. Mungon një lëndë për Sigurinë e Informacionit, ose nuk gjenden tema të ndryshme të sigurisë në lëndë të tjera (përveç një teme në pjesën e Rrjetave). 14. Programi synon që gjatë ciklit të parë të studimeve të përgatisë studentët profesionalisht si specialistë të informatikës në biznes duke ju mundësuar në të ardhmen profilizimin e tyre, si në nivel akademik ashtu dhe profesional. Ndër të tjera, synon të garantojë formim të avancuar dhe kompetenca të specializuara përmes dhënies së njohurive teorike dhe praktike më të thelluara në fushën e teknologjisë dhe të ekonomisë, si dhe të aftësojë studentët për |
|--|---|

| | |
|---|---|
| | <p>kryerjen e kërkimit të pavarur shkencor përmes dhënies së njohurive, metodave dhe teknikave të kërkimit shkencor. DMI është i përqëndruar në hartimin e moduleve që kategorizohen si module Karakterizuese ose Ndërdisciplinore, rreth 70% e programit të studimit.</p> <p>Stafi akademik i DMI është i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në implementimin e politikave që lehtësojnë punësimin e studentëve ose orientimin e moduleve drejt problematikave të tregut të punës. Gjithashtu Stafi akademik ndihmon në rekomandimet e studentëve që paraqet pranë bizneseve që interesohen për punësimin e tyre. Nje rol të rëndësishëm luan edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni, e cila informon studentët për tregun e punës si dhe ruan skedat e punësimit të studentëve.</p> <p>Sugjerimet e mësipërme ndihmojnë në strukturimin më të mirë të njohurive dhe aftësive praktike të studentëve, e për pasojë punësimin më të mirë të tyre.</p> |
| <p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> | <p>Lëndët dhe modulet e ofruara mbulojnë fushat e studimeve të informatikës dhe biznesit duke ju mundësuar studentëve profilizimin në specializime të ndryshme profesionale. Departamenti Matematikë, Informatikë në përfundim të çdo viti akademik realizon një analizë të punës kërkimore dhe shkencore dhe pjesë e kësaj analize është rishikimi i kurrikulës duke e përshtatur me tregun e punës.</p> |
| <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e IT (në nivel programuesi junior ose si specialist IT), por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti. Është për t'u vlerësuar fakti që departamenti i Matematikë Informatikës çdo fund viti kalendarik zhvillon analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku diskutohet ndër të tjera edhe mbi arritjet e objektivave formuese të programit Informatikë Biznesi.</p> <p>Raporti Teori /Praktikë, i përlllogaritur si raporti: (orë totale leksioni) / (orë Seminari + Lab + Ushtrime + praktike), në programin “Informatikë Biznesi” nëse përlllogaritet në bazë të dokumentit “Plani Mësimor”, do të figurojë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Total: 180 ECTS - Praktika: 12 ECTS - Teza: 5 ECTS - Lëndët: 153 ECTS - Orët: Leksion 900 orë; Seminare 870 orë - Total orë: 1770 orë <p>Meqënëse në dokumentacionin e dorëzuar fillimisht nga IAL nuk gjendet një ndarje e qartë e orëve të laboratorëve, iu kërkua GVB të ridorëzonte një listë të lëndëve të cilat zhvillohen në laborator. Kështu, u evidentua që, lëndët e mëposhtme zhvillojnë seminarët e tyre në ambjentet laboratorike të</p> |

UBT:

| Lënda | Leksion | Seminar |
|--|-------------|-------------|
| 1. Hyrje në Informatikë | 3 | 3 |
| 2. Algorit & Struktura të dhënash | 2.5 | 2.5 |
| 3. Menaxhim i teknologjise se Informacionit | 2.5 | 2.5 |
| 4. Sisteme Informacioni në Biznes | 2.5 | 2.5 |
| 5. Database & Menaxhim | 2.5 | 2.5 |
| 6. Sisteme Shfrytëzimi | 2.5 | 2.5 |
| 7. Sistemet e Mbeshtetjes të Vendimmarrjes | 2.5 | 2.5 |
| 8. Programim | 2.5 | 2.5 |
| 9. Bazat e Ekonometrisë (pjesërisht në Lab.) | 4 | 2 |
| 10. Modelim Biznesi | 2 | 2 |
| 11. ASP. Net dhe C# | 2.6 | 1.4 |
| 12. Aplikim Programesh | 2.5 | 2.5 |
| 13. Programim në Internet | 2.5 | 2.5 |
| TOTAL (ECTS) | 34.1 | 30.9 |

Si rezultat:

- Leksione: 78 ECTS
- Seminare: 45.1 ECTS
- Laboratore: 30.9 ECTS
- Praktika: 12 ECTS

Sipas përlogaritjeve, raporti Teori/Praktikë qëndron si 78 / (45.1 + 30.9 + 12), pra është në nivelet është 47% / 53%. Ky është një raport mjaft i mirë për ciklin bachelor. Është gjithashtu një raport që vjen në rritje nga viti në vit në favor të praktikës. Gjithsesi, sugjerojmë përditësimin e kurrikulës dhe me fusha të tjera që evidentojnë më tepër pjesën praktike të çdo lënde, shoqëruar me vlerat përkatëse në orë/ECTS. Për ta përmbledhur, GVJ konstaton se ka një raport të përshtatshëm në ndarjen e veprimtarive formuese.

Së dyti, në dokumentin e veçantë “Kategorizimi i lëndëve, Bachelor, Informatikë Biznesi, 2018-2019”, në Kategorinë A (Lëndë Bazë) janë përfshirë:

1. Matematikë
2. Mikroekonomi I
3. Probabilitet
4. Statistikë 1
5. Statistikë 2

Ndërkohë, në kategorinë B, ndër lëndët karakterizuese të programit të studimit, gjejmë dhe:

1. Matematikë e Zbatuar
2. Makroekonomi I

| | |
|---|--|
| | <p>GVJ sugjeron që Matematikë e Zbatuar të kalojë në lëndët bazë, Kategoria A, kurse Mikroekonomi I dhe Makroekonomi I të mos ndahen në dy kategori të ndryshme, por të përfshihen në një bashkërisht.</p> <p>Sugjerojmë dhe që lëndë bazë mund të jetë dhe “Hyrje në Informatikë”</p> <p>Mund të shtohet dhe një modul tjetër në lëndët e Kategorisë A, për të plotësuar më mirë këtë kategori (për shembull Metoda Kërkimi/Shkrim akademik/Matje, etj).</p> <p>Gjithashtu, natyra praktike e profilit duhet të saktësohet më qartë dhe në syllabus-et e lëndëve, në të cilat duhet të saktësohen orët në laborator dhe punët praktike në terma të krediteve.</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Sipas RVB, programi i studimit konsiderohet në përputhje me komponentët mësimorë që përbëjnë aftësitë formuese. Numri i studentëve që preferojnë të transferohen në UBT në Programin e studimit “Informatikë Biznesi”, ndaj numrit të studentëve të cilët preferojnë të largohen nga ky program pranë UBT është në raportin 2:1.</p> |
| <p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>Syllabuset e moduleve janë përshtatur referuar VKM Nr. 41, por duhet të cilësojmë që literaturat e tyre është e nevojshme të rifreskohen, si dhe të citohen sipas standarteve të mirënjohura, në mënyrë që departamenti të jetë gjithmonë i përditësuar për përmbajtjet e lëndëve të programit të studimit “Informatikë Biznesi”. GVJ konstaton që në pjesë më të madhe të rasteve në syllabus, tek seksioni “Literaturë e detyruar” pedagogët kanë vendosur “Cikël leksionesh”. Këto janë materiale që ne e mirëkuptojmë, që janë të përgatitura dhe përditësuara, por konsiderohen si “materiale të kursit/lëndës” që studentët duhet t’i përvetësojnë, por jo literaturë në të cilën mbështetet korpusi i lëndës.</p> <p>Nga 32 lëndë të marra në analizë nga GVJ, rezultojnë që në 7 prej tyre mungon viti i botimit në të gjithë literaturat, nga 25 që mbeten 10 prej tyre përdorin literaturë të re të 5 viteve të fundit, dhe 15 të tjerat përdorin literaturë më të vjetër se viti 2014. Mungesa e përditësimit të përmbajtjeve lëndore mund të sjellë dobësim të rezultateve të pritshme të të nxënies dhe aftësisimit profesional.</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> | <p>Referuar Rregullores së FEA programet e studimit janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</p> <p>GVJ sugjeron që ky program të orientohet pak më tepër drejt Agrobiznesit (siç e kemi cekur dhe në kritere të mëparshme), në mënyrë që të shfrytëzojë burimet njerëzore, infrastrukturën ekzistuese, mjediset e përbashkëta ku mund të zhvillohen projekte kërkimore apo detyra të natyrave të ndryshme në terren. Në këtë mënyrë ky program do gjendej saktësisht brenda njësisë së tij dhe mbi të gjitha do të plotësonte një drejtim kombëtar mjaft të rëndësishëm, siç është ai i digjitalizimit të agrikulturës, bujqësisë, blegtorisë, fermave, serrave, etj. Në këtë aspekt vendosja e një ose dy lëndëve të tjera me natyrë teknike, por bashkëkohore dhe të aplikueshme në</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | agrobiznes, do e plotësonte më së miri këtë mungesë (p.sh. sugjerojmë IoT, ose të ngjashme) | | | |
| Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | <p>Programi i studimit Informatikë Biznesi është në konformitet me përcaktimet e bëra në Vizionin dhe Misionin e UBT, si një program i rëndësishëm studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive. Është një fushë studimi (brenda fushës së Ekonomisë dhe Agrobiznesit) dhe rezulton se të diplomuarit në këtë program studimesh janë mjaft të kërkuar në tregun e punës. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”, është në dobi dhe në mbështetje të nevojave dhe kërkesave për një lloj diversifikimi të mëtejshëm të diplomave që ofron FEA, në dobi të studentëve që pranohen në këtë fakultet.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimesh mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit. Sipas RVB ata <i>i përgjigjen veçanërisht ndërmarrjeve të agro-industrisë, por dhe jo vetëm, në drejtim të: rritjes së efijciensës së përdorimit të faktorëve të prodhimit, përsosjes së nivelit të menaxhimit, përmirësimit të nivelit të drejtimit operacional, rritjes së nivelit të rendimentit të punës dhe të prodhimit etj.</i> Ritheksojmë që këto prioritetet janë të qarta për FAE dhe DMI, por sikurse i sugjeruam dhe në kriterin e mësipërm, duhet të konkretizohen më fort në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>Vetë studentët e degës, gjatë vizitës në IAL, shprehën mungesën e implementimit të njohurive të marra në fushën e agroindustrisë në përgjithësi, por gjithsesi ishin mjaft të kënaqur me profilin që kishin marrë, si IT në fushën e ekonomisë.</p> <p>Një projekt tjetër i rëndësishëm, me të cilin GVJ u njoh nga dokumentacioni i dorëzuar nga IAL, por edhe gjatë vizitës në institucion është Projekti GRADUA, i cili financohet nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, i cili do të mbështesë universitetet shqiptare duke krijuar një model të integruar kërkesë-ofertë të bazuar mbi të dhënat e databazës së të diplomuarve, përmes: mbledhjes së të dhënave lidhur me performancën e tyre; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe bizneseve; lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës.</p> <p>Implementimi i këtij projekti do të ndihmojë në organizimin e informacionit, duke lejuar kështu edhe monitorimin e vazhdueshëm dhe efektiv të sistemit të trajnimit dhe të tregut të punës, lidhjes së tyre dhe parashikimin e aftësive të nevojshme në të ardhmen, për t’ju përshtatur më së miri këtij tregu. FEA ka nënshkruar gjithashtu mjaft marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, në të cilët studentët realizojnë praktikatat mësimore, gjejnë mundësi punësimi, si dhe ka konsulta të ndërsjellta mes tyre dhe stafit akademik në kuader të përmirësimit të programeve të studimit.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit “Informatikë Biznesi” është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.

Sipas VKM nr. 418, janë përcaktuar raportet e personelit akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.

Nga 34 module që zhvillohen (pa përfshirë praktikën profesionale), të gjitha modulet mbulohen nga personel akademik efektiv. Ndër 27 pedagogët e brendshëm, 10 janë efektivë të DMI, kurse të tjerët janë nga departamente të tjera në FEA.

Stafi i angazhuar në programin BSc në Informatikë Biznesi për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga **23 pedagogë** Personel Akademik Efektiv (me kohë të plotë), nga të cilët 3 me titull Prof. Dr., 5 me titull Prof. Ass. Dr., 10 me gradën shkencore Doktor, dhe 5 me gradë shkencore MSc. Nga 34 module që zhvillohen (pa përfshirë praktikën profesionale), të gjitha modulet mbulohen nga personel akademik efektiv. Ndër pedagogët e brendshëm, 10 janë efektivë të DMI, kurse të tjerët janë nga departamente të tjera në FEA.

GJITHSEJ për vitin akademik **2019 - 2020** kanë dhënë mësim **24 pedagogë** nga të cilët 23 PAE dhe 1 PAK (96% / 4%)

| <u>PAE:</u> | <u>PAK:</u> |
|----------------------|-------------|
| 3 Prof.Dr | 1 Prof. Dr. |
| 5 Prof.As.Dr | - |
| 10 Dr/PhD/Doc | - |
| 0 Msc (Dr në proces) | - |
| 5 Msc | - |

GJITHSEJ për vitin akademik **2018 - 2019** kanë dhënë mësim **29 pedagogë** nga të cilët 27 PAE dhe 2 PAK (93% / 7%):

| <u>PAE:</u> | <u>PAK:</u> |
|----------------------|-------------|
| 4 Prof. Dr | - |
| 7 Prof.As.Dr | - |
| 12 Dr/PhD | - |
| 0 Msc (Dr në proces) | - |
| 4 Msc | 2 Msc |

GJITHSEJ për vitin akademik **2017 - 2018** kanë dhënë mësim **27 pedagogë**

| | <p>nga të cilët 25 PAE dhe 2 PAK (93% / 7%).</p> <table border="1" data-bbox="703 188 1311 477"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>4 Prof. Dr</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>8 Prof.As.Dr</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>9 Dr/PhD</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>0 Msc (Dr në proces)</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>4 Msc</td> <td>2 Msc</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga përbërja e stafit të tre viteve të fundit akademikë vihet re një përbërje e qëndrueshme dhe pothuajse i njëjti raport mes PAE/PAK.</p> <p>Kualifikimi minimal i stafit akademik është “Master Shkencor”. Ndarja e ngarkesës mësimore realizohet në përputhje me gradën shkencore që mban personeli akademik. GVJ konstaton që gjithmonë ngarkesa mësimore është shumë më tepër se norma standarte për kategori.</p> | <u>PAE:</u> | <u>PAK:</u> | 4 Prof. Dr | - | 8 Prof.As.Dr | - | 9 Dr/PhD | - | 0 Msc (Dr në proces) | - | 4 Msc | 2 Msc |
|---|---|-------------|-------------|------------|---|--------------|---|----------|---|----------------------|---|-------|-------|
| <u>PAE:</u> | <u>PAK:</u> | | | | | | | | | | | | |
| 4 Prof. Dr | - | | | | | | | | | | | | |
| 8 Prof.As.Dr | - | | | | | | | | | | | | |
| 9 Dr/PhD | - | | | | | | | | | | | | |
| 0 Msc (Dr në proces) | - | | | | | | | | | | | | |
| 4 Msc | 2 Msc | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Referuar Curriculum Vitae të anëtarëve të stafit akademik të programit të studimit “Informatikë Biznesi”, çdo modul mbulohet nga personel akademik që ka nivelin e duhur akademik me profil studimi në përputhje me fushën kryesore formuese dhe kërkimore të modulit</p> | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> | <p>Sipas Statutit të UBT, veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njërën prej dy shtyllave kryesore mbi të cilat mbështetet misioni i Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ajo konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit të tij akademik duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejtë me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të stafit të tij në botën e kërkimit shkencor.</p> <p>Personeli Akademik i DMI është i ndarë në 2 grupe, ku secili prej anëtarëve të grupit është aktiv në një grup kërkimor si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Modelime matematike në fushën e bujqësisë, ndërtimi dhe analiza e tyre 2. Trajtime matematike të optimizimit dhe zbatime të tyre në ekonomi 3. Dizajnimi dhe zhvillimi i aplikacioneve kompjuterike për desktop dhe ëeb 4. Sistemet e Informacionit dhe menaxhimi i të dhënave | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion</p> | <p>Referuar kreut IV, praktika profesionale, procedurat dhe standardet, në Rregulloren e Programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi”, GVJ konstaton që hartimi dhe ndjekja e praktikave kryhet nga departamenti. Ai harton programin e praktikës profesionale si dhe cakton stafin akademik që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në objekt. Stafi akademik përgjegjës në</p> | | | | | | | | | | | | |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | përfundim të praktikës profesionale, dorëzojnë në departament një raport mbi kryerjen e praktikës profesionale. Praktikatat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private, me të cilat Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka realizuar paraprakisht një kontratë. Praktikatat profesionale zhvillohen në përputhje me profilin e përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Në përfundim, departamenti cakton një datë për mbrojtjen e praktikave nga ana e studentëve. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Departamenti Matematikë Informatikë ka në përbërje stafin ndihmës akademik mësimor, i cili ka përgjegjesi të plotë për mbarëvatjen e laboratorëve kompjuterikë. Stafi ndihmës akademik ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor duke siguruar mjediset laboratorike nga ana teknike si dhe nga ana e mjediseve softëare të nevojshme për praktikatat mësimore. Gjithashtu DMI ka në përbërje edhe staf ndihmës akademik administrativ i cili ndihmon në zhvillimin e DMI si pjesë e strukturës së UBT. Konkretisht në infrastrukturën e UBT bëjnë pjesë: <ul style="list-style-type: none"> - 3 laboratorë për lëndët - 2 laboratorë informatike - Sallë për bibliotekë. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|--|
| Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | Në lidhje me këtë kriter, GVJ gjen të paraqitur në dokumentin “Udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” metodat që UBT ka përshtatur për mësimin online. Të tilla metoda janë: 1. Google site. Nëpërmjet google site stafi akademik krijon një faqe ueb në të cilën hedh të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët si: leksionet, literaturën e rekomanduar, ushtrimet dhe praktikatat, detyrat dhe projektet e kursit, syllabuset e lëndëve, CV personale etj.. Site-t e pedagogëve janë krijuar që në vitin 2010, bazuar dhe në manualin e |

| | |
|---|---|
| | <p>ndërtimit të tyre.</p> <p>2. TEEAL, është një bibliotekë online e aplikuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ku profesorët mund të aksesojnë mijëra publikime të plota.</p> <p>3. Esse3 që është një sistem i integruar për menaxhimin e vlerësimit dhe shërbimeve drejtuar studentëve, si një metodë inovative jo e drejtëpërdrejtë në mësimdhënie, por në rritjen e cilësisë së sigurimit të informacionit. Ky sistem lejon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rritje të efikasitetit administrative për stafin akademik, duke lehtësuar planifikimin dhe realizimin e punës së pedagogëve gjatë programit mësimor, • akses i sigurt dhe besueshmëri e lartë e të dhënave, duke gjeneruar një databazë të vetme digjitale të informacionit universitar. • rritje të cilësisë së shërbimeve administrative dhe mësimore për studentët, • informacion mësimor lidhur me të dhënat e regjistrimeve, grafikun e provimeve online, notat, lëndët etj. <p>Studentët e universitetit kanë mundësi për informacion në çdo kohë dhe nga çdo vend.</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> | <p>Nga dokumentacioni i dorëzuar, si dhe nga takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, konstatohet që Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar dhe zyrtarizuar në Planin Strategjik të UBT 2016-2025.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> | <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrikulturës, së bashku me departamentin e Matematikës e Informatikës, përgjegjës për programin e studimit Bsc në “Informatikë Biznesi”, kryejnë kontrole rutinë në sallat e leksioneve, si process kontrollues i mësimdhënies.</p> <p>UBT në mënyrë periodike realizon dhe vlerësimin e performancës së pedagogëve në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe FEA.</p> <p>Një mënyrë e tretë është dhe realizimi i pyetësorëve, të cilët realizohen në fund të çdo semestri me studentët e UBT.</p> <p>Në pyetësor, studentët pyeten në lidhje me: kushtet e mësimin, bazën didaktike, cilësinë dhe qartësinë e prezantimit të leksioneve e seminareve, korrektesën e mesimit, çështjen e blerjes së teksteve, mitmarrjes, abuzimeve të ndryshme, etj (marrë nga dokumenti “Pyetësor online për studentin”).</p> <p>Pyetësorët në UBT përdoren dhe për stafin akademik dhe ndihmës, në lidhje me cilësinë, kushtet, kërkimin, si dhe për të identifikuar problemet. Pyetësorët ruajnë anonimat.</p> <p>Përveç vlerësimit të kriterëve të ndryshme të mësimdhënies, studentët kanë dhe të drejta të tjera. Në RVB si dhe në rregulloren e FEA cilësohen</p> |

| | | | | |
|--|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| | procedurat për përmirësimin e notës, ankimimit të studentëve, e më pas trajtimi i ankimeve. | | | |
| Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | <p>Në bazë të dokumentacioni të dorëzuar nga IAL, konfirmohet rëndësia që i vihet monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie. Për këtë është ngritur një zyrë e veçantë, Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Misioni i saj përveç funksioneve të tjera është kordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor.</p> <p>Rezultatet e analizës vjetore përmbledhen në një document të detajuar e voluminoz, në të cilin përfshihen: Programet e studimit, Procesi mësimor, Stafi akademik, Studentët, Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm. Sipas RVB, rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik. Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, intervistimet anonime me shkrim dhe në mjedise auditoresh ballë për ballë, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës, etj.</p> | | | |
| Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. | <p>Një nga arsytet e zhvillimit të pyetsorëve dhe shpërndarjes së rezultateve të tyre tek pedagogët përkatës, është edhe nevoja e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, apo të aspekteve të tjera në punë.</p> <p>Gjithashtu, UBT mbështet dhe promovon stafin akademik për kualifikime afatgjata apo afatshkurtra në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të. Në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie, Universiteti ka marrë pjesë në projektet CEPUS, Erasmus Mundus, Erasmus Plus, ku është munduruar mobiliteti i stafit kryesisht në moshë të re dhe në proces kualifikimi. Në dokumentin “Trajnimet e stafit të DMI nëpërmjet projekteve dhe shkëmbimeve në funksion të rritjes profesionale” GVJ konstaton listën e stafit që ka marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, vizita studimore/kërkimore, etj.</p> | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi III.2 | |
| Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | <p>Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>GVJ konstaton që format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë sipas</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>kategorive të ndryshme, sic kërkohen në këtë kriter. Detyrat e kursit dhe projektet janë të specifikuar në çdo syllabus, në rastet kur ato janë të planifikuara nga lektori. Në kurrikulen e studimeve të programit Informatikë Biznesi i është dhënë hapësirë e gjerë si në kredite edhe në kohë praktikës profesionale me qëllim aftësimin profesional të studentëve dhe njohjen me tregun e punë. Gjithashtu janë programuar dhe realizuar orë të hapura nga stafi i fakultetit apo dhe nga staf i ftuar.</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> | <p>Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve dhe nevojat e tyre. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programet e ciklit të parë Bachelor janë të shumëllojshme.</p> <p>Gjithashtu nga RVB, GVJ konstaton që departamenti dhe stafi akademik janë zhvendosur nga forma tradicionale e mësimdhënies në atë bashkëkohore të ndërveprimit, duke e konsideruar veten shpesh në rolin e moderatorit në klasë. Ata theksojnë që disa nga format e mësimdhënies janë laboratorët, puna në grup, si dhe prezantimet.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të të nxënësve.</p> <p>Mjetet e ndryshme teknologjike që stafi akademik shfrytëzon për procesin mësimor, janë të përshtatshme e një përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve. Studentët ndjekin praktika në institucione të ndryshme publike e private dhe ata sjellin në departament kërkesa që mund të kenë punëdhënësit veçanërisht në lidhje me lëndët dhe azhurnimin e programeve të tyre. Kjo është një praktikë me të cilën GVJ u njoh gjatë vizitës në IAL.</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> | <p>Pas shqyrtimit të Curriculum Vitae të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin Bsc në "Informatikë Biznesi", GVJ arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperiencia e tyre profesionale në kompani apo projekte IT apo fusha të tjera.</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Sigurisht që personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm që angazhohet në mësimdhënie është i diplomuar në fushën përkatëse dhe ka kryer studime të mëtejshme në atë fushë. Në varësi të temës personeli akademik përdor edhe metoda të ndryshme të mësimdhënies të cilat i kemi përmendur më sipër.</p> |
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p> | <p>UBT për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjesshme, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore, me të cilën GVJ u njoh dhe gjatë vizitës në IAL. Është departamenti ai që formulon kërkesën për ekspertizën e personave në profesion të specifikuar dhe bën një planifikim paraprak të moduleve që këta pedagogë të rinj do të mbulojnë duke zhvilluar leksionet dhe seminarët.</p> |

| | | | | |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët.</p> <p>Nga vëzhdimi i syllabus-eve të detajuar të lëndëve, GVJ konstaton dhe lëndë të caktuara që përfshijnë diskutimin e rasteve, punën në grup, etj. Këtë e konfirmuar edhe studentët gjatë vizitës në IAL, si dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë kuptohet dhe nga tipologjitë e programeve të instaluar në laboratorët informatikë, që përdoren për seminarët e lëndëve të ndryshme të informatikës (si Dev C++, Eclipse, SQL Server, Visual Studio, SPSS, Ubuntu, etj).</p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit ose projektet lëndore zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të mësojnë nga njëri-tjetri. Studenti në këto prezantime mund të përfshijë literaturë shtesë si dhe të punojë në mënyrë individuale apo në grup. Në kuadër të inkurajimit të studentëve si dhe ndërtimit të një marrëdhënie të ndërsjellë stafi akademik që në prezantimet e para jep informacion për adresën e email-it, zyrën ku ai ndodhet dhe site-n përkatës.</p> <p>Nga vizita në IAL në takimin me studentët u konstatua një marrëdhënie mjaft e mirë mes tyre me njëri-tjetrin e mbi të gjitha kundrejt stafit akademik. U vu re respekt i ndërsjellë, ku studentët u shprehën që për çdo çështje apo problematikë në universitet që ata mund të kishin pasur, u ishin drejtuar pa problem stafit dhe kishin gjetur zgjidhjen ose mirekuptimin e tyre.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, në bazë të RVB, si dhe duke shqyrtuar dokumentacionin, GVJ konkludon që procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. Në bazë të vizitës dhe RVB ambientet e UBT janë të pastra si rrjedhojë e punës që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të institucionit. Ky IAL ofron mjedise të reja e të pajisur plotësisht me të gjithë kapacitetin infrastrukturor dhe teknologjik për të plotësuar kërkesat e programit të studimit si dhe në përputhje me qëllimet e programit. I tërë procesi mësimor i programit të studimeve Bachelor në Informatikë Biznesi, zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B. Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në</p> |
| <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p> | |

| | |
|--|--|
| | <p>përbërje të saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 Salla leksionesh • 14 salla seminaresh, • 4 laboratorë <p>Godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 8 Salla leksionesh • 23 salla seminaresh, • 2 laboratorë <p>Për laboratorët kujdeset stafi ndihmës. Të gjitha sallat ku zhvillohen leksionet janë të pajisura me videoprojektorë dhe të gjithë pedagogët janë të pajisur me laptopin e tyre personal. Brenda ambienteve të universitetit gjenden dy biblioteka, një e universitetit dhe një e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit ku studentët mund të shkojnë në çdo kohë për të studjuar si dhe për të gjetur çdo informacion që atyre ju nevojitet.</p> <p>IAL pohon që këto vlerësime kanë dalë edhe nga rezultatet e pyetësorit online, ku studentët kanë dhënë mendimet e tyre për kushtet e mësimin në përgjithësi.</p> |
| <p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p> | <p>Në bazë të dokumentacionit, institucioni ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Përmendim Google Sites për profilet e pedagogëve dhe lëndëve, sistemin Gradua për Alumni, apo ESSE3. Këto sisteme u demonstruan një pjesë dhe gjatë vizitës në IAL në mënyrë të detajuar.</p> |
| <p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>Në orën e parë të leksionit për çdo modul që zhvillohet në degën Informatikë Biznesi pedagogu përkatës i vë në dispozicion studentëve literaturën bazë dhe ndihmëse që do të përdoret për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Këto materiale janë në formë elektronike ose të printuara. Gjithashtu këto materiale janë edhe në bibliotekën e FEA-s dhe të UBT.</p> <p>Në dokumentin “Lista e teksteve ose leksioneve në bibliotekë në funksion të programit të studimit Bsc në Informatikë Biznesi” përmban 36 tituj librash, kryesisht cikle leksionesh të pedagogëve të lëndëve përkatëse. Mendojmë që ky është një numër mjaft i ulët i teksteve fizike (<i>hardcopy</i>) për të gjithë lëndët e 3 viteve akademike në programin e studimit Bsc në Informatikë Biznesi.</p> |
| <p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> | <p>Sipas RVB, në bibliotekë janë përfshirë periodikë të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë të revistave më influencuese në fushën e ekonomisë dhe agrobiznesit. Nevojitet një plotësim i bibliotekës edhe me tituj nga fusha e Informatikës, megjithatë IAL ka bërë përpjekje serioze për shtimin e këtyre titujve, ku kanë kontribuar programet TEMPUS dhe Erasmus+, donacionet nga universitete partnere si dhe nga vetë stafi e studentët. Gjithashtu në sajë të projektit AHEED është mundësuar krijimi i librarisë elektronike (TEEAL) me akses në disa prej revistave më të mira. Përditësimi i kësaj biblioteke bëhet në vazhdimësi nga IAL.</p> |
| <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët</p> | |

| <p>aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p> | <p>Biblioteka shkencore e UBT është pjesë e komunitetit ndërkombëtar SpringShare. Së fundmi, me vendosjen e Bibliotekës Dixhitale të mundësuar nga RASH studentët do të kenë mundësi të aksesojnë literaturën ndihmëse që ju është dhënë për referencë dhe thellim të njohurive nga pedagogu i modulit përkatës dhe gjithashtu për zhvillimin e temave të diplomave. Kjo literaturë synon të jetë bashkëkohore dhe të përmbajë titujt më me zë të fushave që ndërthuren në programin e studimit Bsc në Informatikë Biznesi ku dallojnë informatika, matematika dhe ekonomia.</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|---|-------|----------|-------|------|---|--------------------|----|------|---|--------------------|----|------|---|---------------------------------|---|----|---|-----------------------|---|-----|---|------------------------|---|----|---|---------------------------------|---|-----|---|-------------------------------------|---|----|---|---------------------------------|---|----|----|-----------------|---|------|----|------------------|---|---|----|-------------------------------|---|----|----|---|---|----|----|--|---|----|
| <p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p> | <p>NË bazë të dokumentit “Infrastruktura e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, GVJ konstaton që hapsirat për realizimin e laboratorëve dhe studimeve specifike janë të mjaftueshme për studentët. Këto paraqiten në tabelën e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="644 667 1458 1182"> <thead> <tr> <th></th> <th>Emërtimi</th> <th>Sasia</th> <th>Sip.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Salla për leksione</td> <td>15</td> <td>2365</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Klasa për seminare</td> <td>24</td> <td>1355</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Salla për aktivitete promovuese</td> <td>1</td> <td>47</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Laboratorë për lëndët</td> <td>3</td> <td>100</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Laboratorë informatike</td> <td>2</td> <td>80</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Salla për bibliotekë + internet</td> <td>1</td> <td>275</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>Mjedis për fotokopjime, librari etj</td> <td>1</td> <td>76</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Zyrë informacioni për studentët</td> <td>1</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>Korridore/holle</td> <td>7</td> <td>3455</td> </tr> <tr> <td>11</td> <td>Mjedise sportive</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>12</td> <td>Mjedise shërbimi për të tretë</td> <td>2</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td>13</td> <td>Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore</td> <td>1</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>14</td> <td>Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj</td> <td>1</td> <td>56</td> </tr> </tbody> </table> <p>Objektivi bazë i Laboratorit të programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi” është, që studentët të zhvillojnë praktikën mësimore për të konkretizuar procesin e mësimdhënies dhe realizimin e kërkimit shkencor, bazuar në metoda standarde si dhe në interpretimin e rezultateve në bashkëpunim me pedagogët e fushave përkatëse. Kështu studentët kuptojnë më mirë teorinë e zhvilluar, aspektet praktike, përfitojnë disa rezultate për përgatitjen e detyrave të kursit, për përgatitjen e tezës së diplomës dhe marrin njohuri teknike. Sugjerojmë që këto mjedise dhe kjo infrastrukturë të zgjerohet më tej në kuadrin e rritjes së kryerjes së kërkimit shkencor nëpërmjet eksperimenteve, përdorimit të pajisjeve matëse, ndërtimit të rrjeteve, financimit të sensorëve dhe pajisjeve të tjera që mund të përdoren në fusha të ndryshme të agroindustrialisë.</p> | | Emërtimi | Sasia | Sip. | 1 | Salla për leksione | 15 | 2365 | 2 | Klasa për seminare | 24 | 1355 | 3 | Salla për aktivitete promovuese | 1 | 47 | 5 | Laboratorë për lëndët | 3 | 100 | 6 | Laboratorë informatike | 2 | 80 | 7 | Salla për bibliotekë + internet | 1 | 275 | 8 | Mjedis për fotokopjime, librari etj | 1 | 76 | 9 | Zyrë informacioni për studentët | 1 | 18 | 10 | Korridore/holle | 7 | 3455 | 11 | Mjedise sportive | 0 | 0 | 12 | Mjedise shërbimi për të tretë | 2 | 50 | 13 | Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore | 1 | 30 | 14 | Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | 1 | 56 |
| | Emërtimi | Sasia | Sip. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Salla për leksione | 15 | 2365 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Klasa për seminare | 24 | 1355 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | Salla për aktivitete promovuese | 1 | 47 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Laboratorë për lëndët | 3 | 100 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Laboratorë informatike | 2 | 80 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 7 | Salla për bibliotekë + internet | 1 | 275 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 8 | Mjedis për fotokopjime, librari etj | 1 | 76 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 9 | Zyrë informacioni për studentët | 1 | 18 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 10 | Korridore/holle | 7 | 3455 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | Mjedise sportive | 0 | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 12 | Mjedise shërbimi për të tretë | 2 | 50 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 13 | Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore | 1 | 30 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 14 | Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | 1 | 56 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> | <p>IAL nuk disponon një platformë për mësimin online. Një nga platformat online e përdorura gjerësisht nga stafi akademik janë faqet e ueb-it (të ndërtura në Google Site). Secili pedagog ka të realizuar google site-n e vet ku ai mund të informojë studentët e tij në lidhje me orët e zëvendësimit apo materiale të ndryshme që ata të mund të shkarkojnë nga site i pedagogut. Komunikime të brendshme mund të realizohen dhe me classroom që mund të jenë të aksesueshme nëpërmjet ftesave sipas email-</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--|---|
| <p>komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p> | <p>eve individuale të studentëve. Në këto classroom pjesëmarrja është e mbyllur ku studentët mund të shikojnë dhe shkarkojnë materiale të ndryshme që pedagogu i modulit mund të vërë në dispozicion.</p> <p>Në UBT përdoret sistemi Esse3 i menaxhuar nga RASH. Esse3 është një sistem i integruar për menaxhimin e vlerësimit dhe shërbimeve drejtuar studentëve, si një metodë inovative jo e drejtëpërdrejtë në mësimdhënie, por në rritjen e cilësisë së sigurimit të informacionit. Ky sistem i siguron studentëve informacion mësimor lidhur me të dhënat e regjistrimeve, grafikun e provimeve online, notat, lëndët etj. Studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi, që e shoqëron atë në gjithë eksperiencën e tij në Universitet, nga aplikimi deri pas diplomimit.</p> |
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> | <p>Realizimi i temave të diplomave si përmbyllje e këtij cikli studimi vendoset në bazë të dokumentit “Rregullore e programit të studimit” po ashtu dhe të departamentit.</p> <p>Diplomimi i studentëve zhvillohet në dy forma: Temë diplome për studentët që kanë mesatare mbi 6.5 dhe provim formimi për studentët e tjerë. Që në fillim studentët që aplikojnë për temë diplome dhe që plotësojnë kriterin përkatës komunikojnë me pedagogun udhëheqës i cili i orienton studentët për të zgjedhur temën e përshtatshme pasi ai edhe e njeh kapacitetin e studentit. Më vonë studentit dhe pedagogu udhëheqës gjatë gjithë kohës bashkëpunojnë për ta përmirësuar hap pas hapi zhvillimin e temës deri në finalizimin me sukses të saj.</p> <p>Nga RVB, ose nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ nuk konstaton ndonjë procedurë që IAL ka vendosur të ndjekë në lidhje me metodat shkencore që studentët duhet të kenë parasysh për diplomën, shkrimin akademik, etj. Kjo u konfirmua dhe gjatë vizitës. Stafit u shpreh që zakonisht ka 2 studentë në udhëheqje dhe kjo e ka bërë situatën të menaxhueshme, pasi, sipas RVB, pedagogu udhëheqës është përgjegjës për cilësinë e temës së diplomës dhe jep vlerësimin e tij për procesin e mbrojtjes. Kjo situatë mund të ndryshojë kur numri i studentëve dhe temave të rritet.</p> <p>Nga dokumenti “Lista e studentëve me temë diplome” konstatohet që natyrat e temave të përzgjedhura për punim diplome janë të natyrës së zhvillimit të programeve në mbështetje të biznesit për vendimmarrje, për publikimin e bizneseve dhe të dhënave ekonomike. Temat kanë qënë kryesisht të natyrës së realizimit të aplikacioneve ueb për funksionet e lartpërmendura. Këtu konfirmojmë dhe njëherë nevojën e përmirësimit të aspektit shkencor të formimit të studentëve, pasi atë teknik konstatojmë që e përmbushin në mënyrë të kënaqshme. Së dyti, konfirmojmë dhe njëherë faktin që programi i studimit nuk është i orientuar drejt agrobiznesit apo ekonomisë bujqësore (sic përmendet në përshkrimet e programit), pasi në këto lista, nga 80 tema të afishuara të 3 viteve të shkuara akademike, vetëm një temë ishte e orientuar dhe ndërthurte IT me agrobiznesin (“Përdorimi i aplikacioneve mobile në ndihmesë të fermerëve shqiptarë”, 2016)</p> |

| | | | | |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| Standardi III.4 | |
|--|--|
| Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirëimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Në IAL Universiteti Bujqësor i Tiranës, veprojnë Zyrat në përbërje të Rektoratit si Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, Zyrës së Studimeve dhe Studentëve si dhe koordinimit me njësitë kryesore në procesin e kontrollit dhe përmirëimit të cilësisë së procesit akademik. Personeli përgjegjës për cilësinë e mësimin në nivel njësie qendrore (FEA) është zëvendësdekani për mësimin dhe kurrikulat i cili emërohet nga dekani¹⁶⁵. Ai nën drejtimin e dekanit organizon, ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në Fakultet, ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e kurrikulave, planeve dhe programeve mësimore, strukturës së vitit akademik etj., për dy ciklet e studimeve (Bachelor, Master Shkencor dhe Master Profesional) në departamente. Ai përgjigjet për organizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e analizave të punës mësimore në departamente dhe ndjek procedurat e vetëvlerësimit në departamente. Një prej detyrave të zëvendësdekanit për mësimin dhe kurrikulat është që në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit të sigurojë përmirësimin e cilësisë nëpërmjet anketimit të studentëve, nxjerrjes së të pikave të dobëta dhe paraqitjes së masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies si në nivelin e formës ashtu edhe atë të përmbajtjes.</p> <p>Në dokumentin “Manuali i cilësisë” janë të përmbledhura në mënyrë të detajuar strukturat në procesin e vlerësimit të brendshëm, kornizat e sigurimit të cilësisë, kontrolli i programeve, etj. Përmendet që një pjesë e mirë e strukturave të UBT kanë rolin e tyre në këtë proces, duke filluar që nga senati akademik, bordi i administrimit, këshilli i etikës, rektorati, dekanati, e deri tek komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Rezultatet e analizave dhe kontroleve bëhen publike në asambljetë e fakulteteve.</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> | <p>Departamenti i Matematikë Informatikës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, është përgjegjëse për programin e studimit “Informatikë Biznesi”. Ai kujdeset për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik, si dhe bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me rregullatorët e institucionit si dhe bazuar në ligjet e arsimit të lartë. Departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes si të pedagogëve ashtu dhe të studentëve që programi i studimit Bsc në Informatikë Biznesi është një program bashkëkohor, madje rëndësinë e këtij programi studimi e kanë shprehur në disa raste dhe analiza në dokumentacionin e dorëzuar, si një drejtim i rëndësishëm dhe i kërkuar dhe studentët dhe tregu i punës.</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | GVJ konstatoi s inga RVB, ashtu dhe nga vizita në IAL që Departamenti Matematikë dhe Informatikë mbështet zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Struktura e ngritur me anë të Google Sites është një prej tyre. Por ka gjithmonë mundësi për të përmirësuar, sidomos pjesën e mësimin online. | | | |
| Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Departamenti ndjek politika lehtësuese për kërkimin shkencor të personelit i cili konsiderohet një aset thelbësor. GVJ konstaton që UBT nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime qe zhvillojnë aftësitë e tyre. Ky IAL ka organizuar konferenca, në të cilat stafi i brendshëm është përjashtuar nga pagesa e artikujve. Mbështetje dhe përjashtim nga pagesat kanë pasur dhe stafi që ka marrë titullin “Doktor”. | | | |
| Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Nga ana e tyre stafi është mjaft i interesuar për të marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare si dhe në trajnime jashtë vendit për të përmirësuar fushën e tyre të kërkimit e për ta pasqyruar këtë dhe në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në këto projekte ka pasur impakt dhe zhvillimi i vetë degës “Informatikë Biznesi”, pasi janë vendosur dhe ura të rëndësishme bashkëpunimi si dhe është zgjeruar rrjeti akademik, që mund të sjellë përfitime të tjera në të ardhmen. | | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Në UBT përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Institucioni bën përpjekje për të promovuar përdorimin e këtyre metodave, por përsëri vihet re se përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre në mësimdhënie përqafohet më kollaj nga brezi i pedagogëve të rinj, ndërkohë që përdoren më pak nga brezi i atyre me më shumë përvojë (vite eksperiencë pune). Në programin e studimit “Informatikë Biznesi”, pjesa më e madhe e stafit u vu re që janë të rinj dhe puna e bërë prej tyre për ndërtimin dhe përdorimin e mëtejshëm të faqeve ëeb dhe sistemeve të tjera mbështetëse është e rëndësishme për programin. | | | |
| Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Sipas RVB, në Departamentin e Matematikës e Informatikës, diskutohet përdorimi i mjeteve audio-vizive; ndërthurja e teorive të përçuara me shembuj të botës reale për të rritur nivelin e asimilimit; nxitja e ideve nëpërmjet punës në grup etj. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi III.5 | |
| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Në lidhje me kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit”, sipas të cilës: nota përfundimtare është shumë e elementeve të një procesi të vazhduar, që përfshin detyra, projektet, angazhimin e studentëve, etj. Saktësisht: |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo | |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - 5-10% pjesëmarrja - 10-15% projekt/detyrë kursi - 20% provimi i ndërmjetëm - 60% provimi përfundimtar. <p>Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve në fillim të çdo lënde. Studentët njihen me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës, në fillim të çdo semestri. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në faqet e pedagogëve.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> | <p>GVJ vlerëson që të gjitha format e vlerësimit të njohurive të përmendura në kriterin 1 dhe 2 i japin mundësi studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Vlerësimi i vazhduar me peshën prej 40% të vlerësimit total, është një element nxitës dhe matës i performancës së studentit. Gjatë gjithë vitit ata janë në një proces të pandërprerë të mësuarit dhe vlerësimit nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, rasteve të studimit etj.</p> <p>GVJ sugjeron që këto masa vlerësimi të mos jenë të njëjta për të tre vitet akademike. Gjatë vitit të parë të studimeve pesha e provimit përfundimtar mund të mbetet në masën 70-80%, ndërsa në vit të tretë, ku detyrat dhe projektet janë më komplekse, pesha e tyre të jetë rreth 50-60%.</p> <p>Së dyti, sugjerohet që detyrat e kursit në ndonjë prej lëndëve të jenë në formën e “short paper”, në mënyrë që studentët të trajnohen me mënyrën e të bërit kërkim shkencor.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p> | <p>Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores të Programit të studimit, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Provimit të ndërmjetëm b. Nivelit të diskutimit në seminare c. Detyrës së kursit/detyra praktike d. Provimit përfundimtar. <p>Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në mes të semestrit (java e 7-të ose e 8-të, sipas Rregullores, seminarët janë të përjavshme, kurse detyrat e tjera</p> |

| | |
|---|--|
| | janë të shpërndara sipas planit të secilit pedagog të lëndës. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Sipas RVB, në programin e studimit të Informatikë Biznesi ka nga ato lëndë në të cilat provimi përfundimtar zhvillohet në kompjutera si për shembull moduli: Sisteme Shfrytëzimi ku një pjesë e provimit realizohet në kompjutera për të kontrolluar mënyrën se si studenti realizon ushtrime të caktuara praktike. Institucioni bashkëpunon me AADF (Albanian-American Development Foundation) dhe po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: “Clean score”, për sekretimin dhe leximin elektronik të testeve. Ky sistem ka nisur të përdoret. |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (“Rregullore e programit të studimit”), si dhe RVB, çdo komision përbëhet nga dy pedagogë njëri prej të cilëve është titullari i lëndës dhe pedagogu tjetër është pedagog që zhvillon module të ngjashme apo dhe mund të ndajë me pedagogun përgjegjës së lëndës pjesën e zhvillimit të seminareve. |
| Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Sipas RVB, UBT ka një format të vetin të fletoreve ku mund të realizohet sekretimi dhe mos njohja e identitetit të studentit deri në momentin që studenti vjen dhe e identifikon vetë fletoren dhe vendos emrin e tij/saj në fletore. Sekretimi është me karbon dhe mbyll kapakun e fletores në pjesën ku janë të dhënat përkatëse si Emër, Mbiemër, Kursi, Lënda. Në momentin që studentit i sekretohet fletorja i vendoset një numër në kapak dhe ai e di se fletorja e tij/saj mban këtë numër. Përsëri sipas RVB, shpesh ky proces nuk është zbatuar. Disa nga arsyet kryesore të kësaj mangësie janë: 1) stafi ndihmës e ka patur të pamundur të mbulojë gjithë procesin e punës pasi orët fizike të punës që kërkon ky proces janë të shumta, 2) në rregulloret e institucionit nuk janë detajuar procedurat sepcifike për këtë proces. IAL nuk siguron infrastrukturë të posaçme dhe mjete survejimi në provimet e lëndëve të programit të studimit. Gjatë vizitës në IAL, në takimin me studentët, u konstatua që studentët kanë marrë komente dhe janë sqaruar në rastet kur nuk kanë pasur qartësi për pjesën e korrigjimit të provimeve. Komentet vendosen dhe në fletoret e studentëve. |
| Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | |
| Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Në programet lëndore (syllabus) të programit të studimit “Informatikë Biznesi” nuk cilësohet në përgjithësi se çfarë penaltitësh mund të ketë një student që konstatohet se ka bërë plagjiaturë në detyrën e kursit /projektit/provimit. Mënyra e zhvillimit të provimeve saktëson që studentët duhet të hyjnë me mjet identifikimi dhe nuk lejohen të kopjojnë, tezat rifreskohen në çdo sezon provimesh, si dhe për tezat e diplomave nuk lejohet plagjiatura. Por, IAL nuk shpjegon se si mundet që pedagogët udhëheqës të zbulojnë plagjiaturën. Në Rregulloren e programit të studimit, Neni 20, një student përjashtohet |

| | nga provimit nëse (pika c): kopjon ose mashtron me mjetet ndihmëse jo të lejueshme. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|------|-----------------|------|----|---------|---|----|---------|---|----|---------|---|----|---------|---|----|---------|---|----|---------|---|----|----------|----|-----------------------|------|--------------|---|-------------|---|-------------|---|--------------|---|--------------|---|--------------|---|--------------|----|
| <p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit”, Kreu III, neni 16, pika 6, studentët mund të hyjnë në provim vetëm pasi konfirmohet nga pedagogu shlyerja e detyrimeve semestrale. Ky proces forcon pjesëmarrjen dhe meritokracinë e vlerësimit. Tabela e vlerësimit të lëndëve, sipas Nenit 19 në të njëjtin dokument, është si më poshtë:</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <table border="1" data-bbox="836 443 1251 674"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Niveli i pikëve</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1.</td> <td>Deri 44</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>2.</td> <td>45 - 54</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>3.</td> <td>55 - 64</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>4.</td> <td>65 - 74</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>5.</td> <td>75 - 84</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>6.</td> <td>85 - 94</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>7.</td> <td>95 - 100</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table> <p>Pra, studentë quhet kalues, nëse merr mbi 44 pikë. Në dokumentin “Rregullore e FEA”, Kreu IX, Neni 63, tabela e vlerësimit është:</p> <table border="1" data-bbox="817 792 1267 1010"> <thead> <tr> <th>Niveli total i pikëve</th> <th>NOTA</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>35 – 40 pikë</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>41 –50 pikë</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>51– 60 pikë</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>61 – 70 pikë</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>71 – 80 pikë</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>81 – 90 pikë</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>91 –100 pikë</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table> <p>Këtu student quhet kalues, nëse merr mbi 40 pikë.</p> <p>Komisioni i provimit duhet të shpallë dhe çelësin e zgjidhjes. Rezultatet hidhen në sistemin ESSE online. Kjo Rregullore nuk përcakton afatet kohore për rezultatet e kontrollit, por nga vizita në IAL gjatë takimit me stafin u konfirmua që rezultatet duhen hedhur brenda 10 ditëve nga data e kryerjes së provimit, kurse ankimimi mund të bëhet brenda 2 ditëve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjen e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem brenda dy ditëve. Pas 12 ditëve (nga data e provimit) sistemi nuk gjeneron më procesverbalin për atë modul.</p> <p>Ndërkohë në dokumentin “Rregullore e FEA”, Kreu IX, Neni 72, pohohet që: “...rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda 2 ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, kur provimi është me shkrim”. GVJ sugjeron përputhjen e dokumenteve dhe procedurave.</p> | Nr. | Niveli i pikëve | Nota | 1. | Deri 44 | 4 | 2. | 45 - 54 | 5 | 3. | 55 - 64 | 6 | 4. | 65 - 74 | 7 | 5. | 75 - 84 | 8 | 6. | 85 - 94 | 9 | 7. | 95 - 100 | 10 | Niveli total i pikëve | NOTA | 35 – 40 pikë | 4 | 41 –50 pikë | 5 | 51– 60 pikë | 6 | 61 – 70 pikë | 7 | 71 – 80 pikë | 8 | 81 – 90 pikë | 9 | 91 –100 pikë | 10 |
| Nr. | Niveli i pikëve | Nota | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Deri 44 | 4 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2. | 45 - 54 | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3. | 55 - 64 | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4. | 65 - 74 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5. | 75 - 84 | 8 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6. | 85 - 94 | 9 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 7. | 95 - 100 | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Niveli total i pikëve | NOTA | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 35 – 40 pikë | 4 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 41 –50 pikë | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 51– 60 pikë | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 61 – 70 pikë | 7 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 71 – 80 pikë | 8 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 81 – 90 pikë | 9 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 91 –100 pikë | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>GVJ konstaton që procedura e ankimeve të studentëve është e dokumentuar në “Rregulloren e programit të studimit, Kreu III, Neni 21. Sipas këtij Neni, student që gjykon se ndaj tij ka pasur shkelje procedurale në vlerësim, i drejton ankesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit dhe këtë ankesë ia përcjell për dijeni Dekanit të FEA. Përgjegjësi i DMI, pasi konsultohet me pedagogun që ka bërë vlerësimin, përcakton nëse ankesa është e drejtë ose jo dhe merr vendimin përkatës.</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>Ky vendim i komunikohet studentit, e njëkohësisht dhe Dekanit të FEA.</p> <p>Ndërkohë, përse i përket ankimimit të studentëve në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë, në dokumentin “Rregullore e FEA”, Kreu IX, Neni 73, pika 1, pohohet që: “...ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 2 ditëve (48 orëve) pas shpalljes së rezultatit dhe i drejtohet dekanit të fakultetit”. Më pas ankesa shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjësën e Departamentit.</p> <p>GVJ konstaton që ankimimi nga ana e studentëve në lidhje me provimet, në dy Rregulloret e përmendura ndjek procedura të ndryshme. Sikundër dhe në kriterin e mëparshëm, departamenti i Matematikë Statistikës, që është përgjegjës për rishikimin e rregullores mësimore të programit të studimit Bsc në “Informatikë Biznesi (“Rregullore e FEA”, Kreu VI, Neni 56, pika 3), duhet të bëjë përputhje të plotë me këtë rregullore.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| Standardi III.7 | |
|---|--|
| Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> | <p>Programi i studimit “Informatikë Biznesi”, sipas dokumentit “Rregullore e Programit të studimit”, Kreu I, Neni 1, <i>synon të përgatisë specialist të aftë për zgjidhjen e problemeve teknike në fushat e ekonomisë, menaxhimit, informatikës dhe programimit</i>. GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të vecanta të studentëve, por GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin/modifikimin e lëndëve të caktuara, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.</p> <p>Ndërkohë në dokumentin “Suplement i diplomës”, përcakton në mënyrë mjaft të detajuar (përtej çfarë përmbajnë të gjithë dokumentet e tjerë përshkrues të programit të studimit) objektivat në drejtimin të fitimit të njohurive, në drejtim të njohurive intelektuale, në drejtim të aftësive praktike. Në këtë dokument, pika 5, “Informacion mbi mundësitë që të jep kualifikimi i fituar” gjejmë të listuara punësimet e ndryshme të të diplomuarve në “Informatikë Biznesi”.</p> <p>Në këtë supplement GVJ kupton më tepër rreth natyrës së të diplomuarve (aftësitë e tyre profesionale, njohuritë, aftësitë e veçanta), GVJ mendon që këto të jenë publike dhe për studentët që në vit të parë në prezantimin me degën (ose dhe më parë, por jo në dokumentin e fundit përcjellës të tyre), prandaj GVJ sugjeron që këto evidencime të reflektohen dhe në dokumentet e tjerë rregullatorë.</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të</p> | <p>Në programin e studimit “Informatikë Biznesi” rreth 50% të lëndëve të</p> |

| | |
|---|--|
| <p>veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit. Në këtë program gjejmë dhe lëndë të disiplinave të tjera si Sociologji, apo Menaxhim Karriere për përmirësimin e ndërveprimit dhe komunikimit. Këto module i japin mundësi studentit të kuptojë tregun e punës, të jetë më komunikues, të jetë i aftë të punojë në grup.</p> <p>Përveç këtyre kemi dhe lëndë plotësuese si është Gjuha e Huaj Anglisht, literaturat plotësuese të lëndëve janë pjesa më e madhe në anglisht (nga vetë natyra e programit të studimit në fushën e informatikës), por nuk ka lëndë që jepen në gjuhë të huaj.</p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p> | <p>Në programin e studimit, për secilin modul të programit të studimit gjendet rubrika Përmbledhje dhe Rezultate e të Nxënit. Në përfundim të modulit stafi akademik bën një vlerësimin të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në syllabusin e modulit. Njësia kryesore dhe njësia bazë organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij.</p> |
| <p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p> | <p>Në përfundim të çdo lënde pedagogu i modulit bën një përmbledhje të çështjeve më të rëndësishme duke i orientuar në lidhje me provimin përfundimtar, zbatimin e tyre në praktikë si dhe sjell raste studimi nga eksperiencia e tij të viteve të kaluara. Një pjesë e mirë e syllabuseve dhe planeve kalendar të moduleve kanë të parashikuara seanca speciale për përsëritjen e lëndës, pra evidentimin e temave më të rëndësishme mesqarimet e nevojshme. Departamenti garanton realizimin e këtij procesi nëpërmjet anketave të vazhdueshme me studentët.</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Përgjithësisht personeli akademik i brendshëm integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studenëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Në Planin e Aktiviteteve të UBT-së një nga pikat është edhe zhvillimi i Leksione të Hapura nga personalitete të ftuara të fushës.</p> |
| <p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p> | <p>NË programin e studimit “Informatikë Biznesi”, përveç leksioneve janë dhe seminarët të cilat aplikojnë çdo njohuri të marrë në leksione duke i zbatuar ato me përdorimin e softuerëve që ndodhen të instaluar në laboratorët e programit të studimit, të tillë si: DevC++, SQL Server, Ubuntu, Visual Studio, etj.</p> <p>Gjithashtu, për t'i dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë më shumë njohuritë e tyre në praktikë kurikula e programit të studimit Informatikë Biznesi u ndryshua në shtator 2017 dhe hyri në fuqi për studentët e regjistruar në kursin e parë në vitin akademik 2017-2018, duke i lënë një semestër të tërë praktikës profesionale.</p> |
| <p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> | <p>Gjatë vizitës në IAL, në takimin me stafin GVJ konstatoi mirëkuptimin dhe dëshirën e stafit për të zhvilluar më tej programin e studimit. Në këtë takim morën pjesë pothuajse pjesa më e madhe e stafit akademik, edhe pse vizita u zhvillua në kushte jo të zakonshme, si pasojë e Covid-19.</p> <p>Të gjithë anëtarët e DMI i diskutojnë çështjet që lidhen me programin e studimit Informatikë Biznesi në nivel GMK dhe më pas në nivel</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | departamenti dhe për programet e tjera ku ata janë të angazhuar për të dhënë mësim. Gjithashtu anëtarët e departamentit DMI bashkëpunojnë dhe me anëtarët e departamenteve të tjera që zhvillojnë mësim në programin e studimit IB. Nga ana tjetër pedagogët e DMI diskutojnë dhe bashkëpunojnë me sektorin e IT-së për mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe rrjetit përkatës (p.sh formatimi dhe gjetja e softëare-eve të ndryshme si paketa Microsoft Office, Eëindoës 10, etj). | | | |
| Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Në programet lëndëve GVJ konstaton që në shumicën e lëndëve studentët zhvillojnë projekte kursi dhe detyra kursi. Projektet dhe detyrat e kursit përfshihen dhe në vlerësimin e vazhduar të studentit, kështu që kjo përveçse i ndihmon studentët për të rritur frymën e bashkëpunimit në grup dhe për të marrë njohuri më të thella lidhur me lëndë të caktuara i ndihmon ata edhe për një vlerësim më të plotë të lëndës përkatëse. GVJ mendon që për të zhvilluar idetë innovative, për të kryer studime të avancuara kërkimore e shkencore detyrat e kursit nuk mund t'i plotësojnë mjaftueshëm këto aftësi. Në rastin më të mirë, këto aftësi plotësohen duke përfshirë stafin dhe studentët në projekte kërkimore. Një formë tjetër mund të jetë duke kërkuar financime nga Alumni, ose nga biznese që FEA/DMI ka marrëveshje për të financuar sadopak projekte, iniciativa, pajisje të vogla (sensorë, aparatë matës, pajisje rrjeti, njëjë përpunuese, etj). | | | |
| Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Në UBT, studentët që kanë mesataren 9 deri në 10 dhe studentët të kategorive të caktuara, përfitojnë bursë mujore sipas vendimeve të bordit të administrimit dhe të senatit për bursat. GVJ nuk konstaton ndonjë formë tjetër mbështetjeje financiare, por FEA organizon konferenca studentore të përvitshme. | | | |
| Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Sikurse është përmendur në kriteret e mësipërme që lidhen me kualifikimin e stafit, një pjesë e tyre janë trajnuar jashtë vendit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të. Gjithashtu programet e studimit në FEA janë të unifikuar me programet e universiteteve partnere në mënyrë që studentët të shkëmbejnë eksperiencë me homologët e tyre. Në ndihmë të plotësimin të këtij kriteri vijne dhe programet e ndryshme të shkëmbimit të studentëve. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|---|---|
| Standardi III.8 | |
| Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Në dokumentin “Rregullore e Brendshme e Departamentit të Matematikës dhe Informatikës” janë të hartuara dhe përcaktuara procedurat e posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës. Procedurat dhe standartet e diplomimit janë të renduara në Kreun VII, Neni 57-67. |

| | <p>Ky dokument është bërë publik në faqen zyrtare të fakultetit në këtë link: https://ubt.edu.al/ëp-content/uploads/2019/04/Rregullore-FEA.pdf</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|---|-----------------------|---|---|------------------|---|---|---------------------|----|---|-------------------------------|----|---|------------------------|----|---|--|----|---|--------------------------|----|---|------------------------------------|----|---------------|--|------------|
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> | <p>Departamenti vë në dispozicion të studentëve formatin e Diplomës (sipas dokumentit të dorëzuar), në të cilin janë të përcaktuara jo vetëm rregulla të formatimit të tekstit, por ka dhe instruksione për përmbajtjen, çështjet kryesore që duhet të mbajë tema, hipotezat, referencat etj. Gjithashtu, në RVB cilësohet që <i>pedagogët udhëheqës asistojnë studentët që kanë nën udhëheqje për shkrimin e temës së diplomës duke i ndihmuar ata me materiale, me ndarjen në çështje dhe nënçështje, në mënyrën se si japin detajet për zhvillimin e programeve si dhe në dhënien e konkluzioneve.</i> GVJ konstaton që kjo është një ndihmë e rëndësishme që u jepet studentëve, por theksojmë sërish që për procesin e shkrimit të një punimi shkencor/diplome ata duhet të jenë instruktuar në një lëndë të veçantë ose në përbërje të ndonjë lënde ekzistuese.</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Studentët me mesatare nën 6.5 zhvillojnë provim të përgjithshëm, të cilëve u vihet në dispozicion një listë me 60 pyetje/ushtrime në bibliotekën universitare. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Diploma ose provimi final zhvillohen në semestrin e gjashtë dhe kanë 5 ECTS</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p> | <p>Në bazë të dokumentit “Rregullore e brendshme e departamentit”, Neni 60 “Procedurat e zgjedhjes, përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës”, pikat 1-3, temat e diplomave udhëhiqen nga stafi mësimor-shkencor që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master), apo nga punonjës të tjerë shkencorë të FEA. Sipas RVB, <i>gjatë periudhës së sezonit të provimit përfundimtar/temës së diplomës stafi akademik është në dispozicion të studentëve për pyetjet e ndryshme që ata mund të kenë. Pranë sekretarisë së departamentit nga ana e stafit dorëzohet axhenda javore e cila tregon edhe oraret se kur stafi akademik është në zyrë dhe mund të presë studentët.</i></p> <p>Pra, GVJ konkludon që orientimi dhe ndihma e personelit akademik për studentët në përgatitjen e temës së diplomës realizohet nëpërmjet konsultimit, në rastet kur studenti ka nevojë. Në dokumentin “Vlerësim diplome” rubrikat e vlerësimit dhe pikët përkatëse plotësohen nga udhëheqesi i temës, sipas tabelës së mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="657 1626 1428 1951"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Rubrikat e Vlerësimit</th> <th>Struktura e pikëve në dispozicion të çdo elementi vlerësues</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Zgjedhja e temës</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Struktura e Punimit</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Metoda e Punës dhe e Kërkimit</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Angazhimi i kandidatit</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Qartësia e të shkruarit dhe trajtimi i çështjeve</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Përfundime & Rekomandime</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Vlerësimi i përgjithshëm i punimit</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td colspan="2" style="text-align: center;">Totali</td> <td>100</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në këtë tabelë, angazhimi i kandidatit vlerësohet me 25 pikë, njësoj sa</p> | Nr | Rubrikat e Vlerësimit | Struktura e pikëve në dispozicion të çdo elementi vlerësues | 1 | Zgjedhja e temës | 5 | 2 | Struktura e Punimit | 10 | 3 | Metoda e Punës dhe e Kërkimit | 15 | 4 | Angazhimi i kandidatit | 25 | 5 | Qartësia e të shkruarit dhe trajtimi i çështjeve | 10 | 6 | Përfundime & Rekomandime | 10 | 7 | Vlerësimi i përgjithshëm i punimit | 25 | Totali | | 100 |
| Nr | Rubrikat e Vlerësimit | Struktura e pikëve në dispozicion të çdo elementi vlerësues | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Zgjedhja e temës | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Struktura e Punimit | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | Metoda e Punës dhe e Kërkimit | 15 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | Angazhimi i kandidatit | 25 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Qartësia e të shkruarit dhe trajtimi i çështjeve | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Përfundime & Rekomandime | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 7 | Vlerësimi i përgjithshëm i punimit | 25 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Totali | | 100 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--|--|
| | <p>edhe Struktura dhe Metoda e kërkimit bashkë. Meqënëse ky është një vlerësim i matshëm në mënyrë cilësore dhe jo sasiore, GVJ mendon që mund të bjerë lehtësisht në vlerësim subjektiv. Të njëjtin diskutim, GVJ e ka dhe për fushën Vlerësim i përgjithshëm i punimit, i cili zë përsëri 25 pikë. Pra, 50% e vlerësimit të udhëheqësit janë pikë për të cilat një udhëheqës nuk mund të ketë një argument të qartë profesional, nëse ankohet nga një student. Në këtë dokument udhëheqësi vlerëson dhe me notë punimin, por GVJ konstaton që në dokumentin “Rregullore e brendshme e departamentit”, Neni 61, pika 3, pohohet që: <i>“për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet e vlerësimit konsiderojnë: (a) punimin e paraqitur në formë të shkruar e të lidhur, (b) prezantimin e punimit për diplomë nga ana e studentit gjatë mbrojtjes në komision, (c) përgjigjet e studentit nga pyetjeve të komisionit, (d) vlerësimin e reaçensës dhe mendimin e udhëheqësit të temës”</i>. Ndërkohë në një pikë më poshtë, Neni 61, pika 4, pohohet që: <i>“...nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ditën e mbrojtjes përpara komisionit”</i>. Për këtë pikë, GVJ sugjeron që pikat 3 dhe 4 të riformulohen, në mënyrë që të mos shfaqin sikur ka paqartësi për procesin e vlerësimit të diplomës.</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Sipas RVB, në rastin e punimit të diplomës në programin e studimit bachelor në Informatikë Biznesi institucioni i asiston studentët duke ju vendosur në dispozicion laboratorët dhe gjithë mjediset e FEA dhe jashtë orarit zyrtar të mësimin. Studentët mund të shfrytëzojnë kompjuterat dhe programet e instaluar në rastet kur nuk janë të pajisur me laptop personal. Në këtë kriter kërkohet dhe asistencë e IAL për kryerjen e matjeve e analizave, pra procedurave eksperimentale. GVJ rithekson nevojën që ka ky program studimi veçanërisht për zhvillimin e këtyre proceseve, shumë më tepër se programe të tjera të ngjashme studimi në IAL shqiptare.</p> |
| <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Në departamentin e Matematikës dhe Informatikës, udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar.</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p> | <p>Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit dhe pedagogu. Në fund të punimit, pedagogu udhëheqës vlerëson në një dokument të veçantë punimin, siç u shpjegua dhe në kriteret e mëparshme.</p> <p>Studenti në fund të provimit, ose të mbrojtjes së diplomës vlerësohet me notë.</p> |
| <p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>Sipas dokumentit “Rregullore e brendshme e departamentit”, Neni 62, studentit që kalon me sukses temën e diplomës/provimin e formimit pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet atij së bashku me “Shtojcën e diplomës” (diploma supplement). Në dokumentin e diplomës shënohet fusha e studimit të përfunduar dhe specialiteti përkatës.</p> <p>Në Urdhërin nr 405, datë 08.09.2017, për “Regjistrimin e formave të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | diplomave bachelor, master profesional dhe master i shkencave të Universitetit Bujqësor të Tiranës”, gjendet dhe Diploma Bachelor në “Ekonomi dhe Agrobiznes”, profili “Informatikë Biznesi”. Po kështu, edhe Suplementi i Diplomës është i bazuar mbi modelin e hartuar nga Komisioni European, Këshilli i Europës dhe UNESCO/CEPES. | | | |
| Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Në raste të tilla studentët depozitojnë pranë ZSS (Zyra e Studimit dhe Studentëve) një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe vulurur e programit të ciklit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Studenti i diplomuar, sipas dokumentit “Kërkesë për shërbime”, mund të kërkojë një kopje të diplomës, të suplementit, të programeve të lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze, përkundëjt pagesës dhe e merr brenda një afati kohor 2-5 ditë. | | | |
| Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor rregjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (“Rregullore e brendshme e departamentit”, Neni 65). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|---|--|
| Standardi IV.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ. | Gjatë vizitës në institucion Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësuesin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Pagave. Gjatë këtij takimi në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësues dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin diplomat, çertifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, vlerësimin akademik, etj. Kjo gjë u konstatua gjatë shqyrtimit të disa dosjeve të protokolluara, të cilat u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme nga GVJ. Gjatë bisedës me përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, e cila është |

| | |
|---|--|
| | <p>një strukturë nën varësinë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Pagave në UBT, GVJ u informua që përditësimi i dokumentacionit bëhet çdo vit nëse ka nevojë, në rastin kur personeli ka ndryshime në nivelin e gradave apo titujve akademik. Gjithashtu GVJ u informua që kjo zyrë po punon për të skanuar të gjithë dokumentat dhe për të krijuar bazën elektronike të të dhënave të pedagogëve.</p> <p>Informacioni për angazhimin e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi sipas çdo semestri apo viti akademik mbahet edhe në department, i cili çdo vit ruan dhe përditëson CV e pedagogëve të cilat ngarkohen çdo vit në faqet personale të ueb-it të stafit akademik.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> | <p>Në bazë të “Rregullores për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ në UBT” Neni 1, rekrutimi i stafit në UBT bëhet duke zbatuar procedura që janë në përputhje me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; b. Kodin e punës; c. Statutin e UBT-së; d. Rregulloren e Studimeve të UBT-së. |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> | <p>Në këtë Rregullore janë përcaktuar qartë kërkesat dhe standardet për rekrutimin e personelit akademik në UBT Neni 3, kërkesat dhe standardet për rekrutimin e personelit ndihmës akademik në UBT Neni 4, kërkesat dhe standardet për rekrutimin e personelit administrativ në UBT Neni 5. Në këtë Rregullore përcaktohen kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e veçanta të cilat bëhen publike në Buletinin e APP-së dhe në faqen e ueb-it të UBT tek rubrika njoftime, në seksionin njoftime për oferta punësimi.</p> <p>Të gjitha procedurat për rekrutimet e reja ndiqen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Pagave, që nga shpallja e vendeve vakante, përcaktimi i kritereve, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, deri tek vendimi i emërimit.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithëshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Në bazë të “Rregullores për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ në UBT” përcaktohen kriteret e përgjithëshme dhe specifike për vlerësimin dhe rekrutimin e kandidaturave të mundëshme për vendet e punës të shpallura vakante.</p> <p>Për rekrutimin e stafit akademik kriteret e përgjithëshme (ku vlerësohen kryesisht formimi akademik, grada shkencore dhe nota mesatare) përcaktohen nga Senati i institucionit dhe i bashkëlidhen rregullores. Kriteret specifike përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit për mbulimin e lëndëve apo moduleve të ndryshme, dhe miratohen nga Rektori.</p> <p>Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka nivelin e duhur akademik në përputhje me përmbajtjen e moduleve apo lëndëve që ata japin mësim.</p> |
| <p>Shkalla e përmbushjes së</p> | <p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p> |

| | | | | |
|------------|-----------|------------|-----------|------------|
| standardit | përbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi IV.2 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Gjatë vizitës në UBT si edhe mbështetur në dokumentacionin e dorzuar nga institucioni (“Të dhëna për infrastrukturën e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit”) u konstatua se institucioni ofron mjedise të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit si p.sh. zyra komode, laboratore për zhvillim të mësimdhënies dhe projekteve të tyre, pajisje teknike, internet falas, etj. Gjatë takimit me stafin akademik GVJ u informua se mjediset në institucion si dhe aksesit në bibliotekën shkencore “Mentor Përmeti” si edhe në atë on line ju ka mundësuar atyre kryerjen e detyrave në mënyrë sa më profesionale. |
| Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (“Analiza e punës shkencore 2018” e Departamentit “Matematikë-Informatikë”, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit; “Lëvizjet e stafit akademik të UBT në kuadër të projekteve të mobilitetit 2017-2018”; “Performanca akademike”) GVJ konstatoi se insitucioni nxit kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik duke ju ofruar mundësi financimi për zhvillimin dhe publikimin e rezultateve nga kërkimet e tyre shkencore, si dhe duke vendosur procedura të pikësimit për arritjet e tyre. Gjithashtu në takimin me stafin akademik GVJ u informua që institucioni ka mbështetur stafin në procesin e kualifikimit të vazhdueshëm si në kuadër të mundësive që ofrohen nga zhvillimi i projekteve të institucionit (IPA, Erasmus +, Horizon 2020), edhe duke mbështetur financiarisht tarifat e shkollës së doktoraturës për të gjithë asistent lektorët e regjistruar në këtë proces. Në këtë kuadër mund të themi se institucioni inkurajon dhe mbështet aftësimin e personelit akademik për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, teknologjive të reja dhe eksperiencave më të mira të universiteteve në vend dhe jashtë si rezultat i projekteve të përbashkëta në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. |
| Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | |
| Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Departamenti i “Matematikë-Informatikës” përgjegjës për programin e studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” përbëhet nga 15 anëtarë personel akademik efektiv nga të cilët 2 me titullin Prof. Dr., 3 me titullin Prof. Asoc. Dr., 6 me gradën shkencore Dr., dhe 4 personel Msc. Gjithashtu departamenti ka edhe 3 anëtarë personel ndihmës. Për përbushjen e nevojave dhe objektivave të këtij programi studimi departamenti ka angazhuar 27 pedagogë personel akademik efektiv që janë anëtarë të këtij departamenti dhe të departamenteve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, si dhe 2 pedagogë si personel akademik me kohë të pjesëshme. nga të cilët 4 me titull Prof. Dr., 7 me titull Prof. Ass. |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | Dr., 12 me gradën shkencore Doktor, 1 Docent dhe 5 MSc. Në bazë të kësaj strukture GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” angazhon burime njerzore të kualifikuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket numrit të personelit efektiv dhe kualifikimit të tyre. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi IV.3 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | I gjithë procesi mësimor në funksion të programit të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” zhvillohet në godinat e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi. FEA e zhvillon aktivitetin në 2 godina të ndërlidhura, pjesë e kampusit të UBT dhe ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatme për zhvillimin e mësimin si për lëndët teorike dhe ato praktike. |
| Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (“Të dhëna për infrastrukturën e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit”; “Analiza e punës shkencore 2018” e Departamentit “Matematikë-Informatikë, Pika 2.10”), si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se fakulteti ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore duke përfshirë: 15 salla leksionesh të pajisura me video-projektorë, 24 salla seminaresh dhe 5 laboratorë informatike. Gjithashtu në funksion të studentëve dhe pedagogëve për mbështetje të procesit mësimor janë edhe dy biblioteka, një e universitetit dhe një e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit ku studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e studimit, kompjuterat për përdorimin e internetit dhe bibliotekat on line. |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Për nevojat specifike të këtij programi studimi janë vënë në dispozicion 2 nga laboratorët e informatikës të FEA, të cilët janë të pajisur me kompjuterat të rinj dhe me programe të cilat në përgjithësi janë të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve të programit, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. Megjithatë nga vizita në institucion në takimet me studentët dhe pedagogët GVJ u njoh me disa problematika që lidhen me mungesën e softëare-ve të veçantë dhe të përditësuar, që duhet të jenë të pajisur kompjuterat në laborator për nevojat specifike të këtij programi studimi. Ky problem është reflektuar edhe në dokumentin “Raport mbi analizën e |
| Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | veprimtarisë mësimore viti akademik 2017 – 2018, FEA”. | | | |
| | I gjithë ambienti universitar është i mbuluar me sinjal Ëi-Fi me qëllim qasjen në internet në çdo kohë nga ana e studentëve dhe personelit. | | | |
| | Për lëndët ndërdisiplinare të programit përdoren edhe laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera të UBT të cilët janë të listuar në dokumentin 33 “Kapacitete UBT, Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (sallat laboratorët), hapësirat ndihmëse”. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Për kryerjen e praktikës profesionale UBT, nëpërmjet Qendërs së Karrierës dhe Alumnit, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës në vend (institucione publike dhe private). | | | |
| | Vëmë re që ka një mungesë të përfshirjes së mjediseve dhe kapaciteteve të vetë institucionit për të realizuar praktikat profesionale të këtij programi studimi në bashkëpunim me fakultetet e tjera për të bërë një ndërthurje midis mundësive që ofron teknologjia me disipinat e tjera të studimit në UBT (siç janë agronomia, blektorja, etj.) | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| | |
|---|--|
| Standardi IV.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (“Biblioteka e UBT dhe e FEA-s”), si edhe gjatë vizitës në mjediset e UBT, GVJ konstatoi se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve për mbështetje të procesit mësimor dy biblioteka, njëra është Biblioteka Shkencore e Universitetit “Mentor Përmeti” dhe tjetra është Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, ku studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e studimit, kompjuterat për përdorimin e internetit dhe bibliotekat on line. |
| | Gjithashtu në dispozicion të studentëve në funksion të mbështetjes së programeve mësimore, është edhe Libraria Universitare e cila ju mundëson studentëve gjetjen e materialeve të printuara të leksioneve, librat mësimorë, dhe materiale të tjera shtesë që pedagogët i kanë referuar në funksion të mësimin. |
| | Të gjithë studentët kanë akses të barabartë në të gjitha mjediset e sipërpërmendura. |
| Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të | Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (“Biblioteka e UBT dhe e FEA-s”), si edhe gjatë vizitës në mjediset e UBT, GVJ konstatoi se bibliotekat e UBT zotërojnë një fond të pasur të literaturës fizike në gjuhën shqipe dhe të huaj, përkatësisht 16259 libra tekniko-shkencor nga |

| | |
|--|--|
| <p>nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>të cilët 6866 në gjuhën shqipe dhe 9393 në gjuhë të huaj.</p> <p>Gjithashtu një burim i vlefshëm informacioni dhe dijesh janë edhe mbi 2000 periodikë për të gjitha disiplinat e UBT, nga të cilët vlen për tu theksuar fondi i periodikëve të shkarkuar nga ELSEVIER, si një burim i vlefshëm i informacionit shkencor.</p> <p>Gjithashtu në funksion të këtij programi studimi studentët mund të gjejnë në këto biblioteka të gjithë literaturën bazë të referuar (çdo tekst i botuar dorëzohen në 5 kopje) si dhe literaturat e tjera ndihmëse prej 36 titujsh. Megjithatë duke u bazuar tek dokumenti “Lista e teksteve ose leksioneve në bibliotekë në funksion të programit të studimit Bsc në Informatikë Biznesi” GVJ konstaton se në bibliotekë studentët nuk orjentoohen në mënyrë të qartë për titujt e librave në funksion të këtij programi studimi që ata mund të aksesojnë në bibliotekat online të cilat institucioni i ka vënë në dispozicion të tyre.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Në funksion të këtij programi studimi por jo vetëm, UBT ka ofruar kushte dhe akses falas dhe me abonim në burimet on line të informacionit, mundësuar nga projekte të ndryshme, aktualisht <i>Research4life</i> me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI. Gjithashtu institucioni përdor platformën on line <i>Springshare LNSS</i> në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Netëork Support Services”.</p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> | <p>Një tjetër platformë, “Biblioteka On-line”, është krijuar nga bashkëpunimi i UBT me RASH, e cila i ofron akses në libra, revista shkencore, arikuj dhe video të gjithë studentëve dhe pedagogëve të këtij universiteti.</p> <p>Këto biblioteka ju mundësojnë studentëve të këtij programi studimi shfrytëzimin pa kufizim të burimeve të informacionit nëpërmjet posteve të studimit të literaturës fizike si dhe posteve në kompjuterat e sallës në të cilët mund të aksesohen bibliotekat on line. Përkatësisht në dispozicion të tyre janë:</p> <p>Biblioteka Shkencore “Mentor Përmeti me katër salla:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Salla e librit tekniko-shkencor “Vasfi Samimi” që ka një kapacitet 35 poste dhe frekuentohet nga studentë dhe pedagogë. • Salla e studimit dhe e kompjuterave për studentët që ka një kapacitet 50 poste dhe 10 kompjutera. • Salla e pedagogëve dhe eventeve që ka një kapacitet 35 poste. Ka 6 kompjutera, një skaner/fotokopje/printer, një videoprojektor. Kjo është sallë për studim për pedagogët, për aktivitete me studentët, (Forumi Ekonomik Studentor), ëorkshop-e, trajnime, si dhe për promovime të ndryshme. • Salla e librit artistik dhe periodikut që ka një kapacitet 40 poste dhe frekuentohet nga studentë dhe pedagogë. <p>Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit me kushte moderne ka 100 poste. Ajo ka lidhje të pandërprerë me internetin dhe 10 kompjutera në funksion të fondit on-line TEEAL me rreth 200 revistave, produkt i një bashkëpunimi me Universitetin e Haëait, USA.</p> |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> | <p>Institucioni ka si politikë pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me titujt të rinj në mbështetje të të gjithë programeve të studimit. Në dokumentin “Relacion përmbledhës për pasqyrat financiare për vitin 2017” institucioni ka parashikuar një fond për pasurimin e bibliotekës të FEA në vlerën 6,064,329 Lek.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se përgjegjësit e departamenteve dhe programeve të studimit, në bashkëpunim me fakultetet, rektoratin dhe financën, hartojnë plane për të shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik. Mbështetur tek dokumenti 30.1, 30.2 dhe 30.3 “Analiza e departamentit përgjegjës (vjetore periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit” për vitet akademike për 2015-2016, 2016-2017 dhe për 2017-2018 departamenti ka analizuar në mënyrë të detajuar gjendjen dhe nevojat për materialet didaktike në funksion të procesit mësimor. Megjithatë GVJ konstaton se pavarësisht fondit të përcaktuar nga institucioni për pasurimin e bibliotekës të FEA, institucioni nuk ka paraqitur një plan të detajuar me tituj librash, për përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të këtij programi studimi.</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hënë në të premte 8.00 – 16.00, në përputhje me oraret kur zhvillohet mësimi në këtë institucion. Oraret e saj janë publike dhe funksionon sigurisht përmes kartelave të regjistrimit.</p> <p>Frekuentimi i bibliotekës është rreth 2000 studentë në muaj.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X | |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>UBT disponon një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të informacionit të krijuar në bashkëpunim me projektin e RASH. Për administrimin e informacionit që lidhet me studentët institucioni përdor sistemin ESSE3 (https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/Home.do), i cili është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, orientimit, aplikimit në universitet dhe jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi (që i jepet nga sekretaria kur regjistrohet) që e shoqëron atë në gjithë eksperiencën e tij në Universitet nga aplikimi deri pas diplomimit.</p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Pagave si dhe Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, GVJ u informua se institucioni ka një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit në</p> |

| | |
|--|---|
| <p>akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>lidhje me personalin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>UBT e administron informacionin dhe dokumentacionin e tyre që lidhet me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor nëpërmjet një sistemi të brendshëm i cili menaxhohet nga Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Kjo degë është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UBT dhe funksionon si njësi ndihmëse e rektoratit. Dega, varet nga Rektori i Universitetit dhe ka lidhje të drejtpërdrejta me Zëvendës-rektorin për problemet e mësimin.</p> <p>Gjithashtu informacioni dhe dokumentacioni shtesë në lidhje me personalin akademik, ndihmës akademik dhe administrative mbahet edhe nga Zyra e Burimeve Njerezore, e cila është një strukturë nën varësinë e Drejtorisë së Burimeve Njerezore dhe Pagave në UBT. Ky informacion administrohet në dosje dhe po punohet për të krijuar një bazë elektronike të tij.</p> <p>Gjithashtu informacioni për personelin gjendet edhe në faqen e ëeb-it të institucionit, i cili përfshin CV-të, lëndët apo modulet ku ata janë të përfshirë, leksionet, etj.</p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Sistemi i menaxhimit të studentëve ofron informacion të dedikuar sepse studentët pasi regjistrohen në sekretarinë mësimore, kryejnë edhe regjistrimin në sistemin elektronik të sekretarisë (ESSE 3), ku pajisen me “emrin e përdoruesit” personal dhe “fjalë kalimin” që ju shërben atyre për të parë të gjithë informacionin në lidhje me procesin mësimor dhe rezultatet e arritura.</p> <p>Informacioni për personelin është i aksesueshëm për të gjithë të interesuarit nëpërmjet faqes së ëeb-it të institucionit, si edhe sipas kërkesave pranë Zyrës së Burimeve Njerezore.</p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> | <p>GVJ konstaton se UBT disponon sisteme të integruara të menaxhimit të informacionit. Në sistemin Esse3 përveç studentëve edhe personeli akademik ka llogari individuale, që shërben për shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve, sekretarisë dhe studentëve.</p> <p>Gjithashtu një tjetër sistem i menaxhimit të informacionit administrohet nga Zyra e Studimeve dhe Studenteve ku bëhet regjistrimi i studentëve dhe mbajtja e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre.</p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin e zhvilluar me përfaqësues të Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, si dhe në bazë të dokumentave apo shqyrtimit të informacionit në faqen e ëeb-it të institucionit, GVJ u informua që në kuadër të menaxhimit të informacionit të aktivitetit akademik dhe administrativ kjo degë ndjek dhe monitoron në kohë reale (nëpërmjet sistemit ESSE 3) problemet që kanë lidhje të drejtpërdrejta me procesin mësimor në UBT, me të gjitha procedurat, aktivitetet dhe dokumentat e studimit dhe studenteve, vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucioni, si edhe kontrollin dhe harmonizimin e dokumenteve administrative, që rregullojnë zhvillimin normal të procesit mësimor në nivel fakulteti apo universiteti duke mbajtur lidhje edhe me dekanët e fakulteteve.</p> |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik,</p> | <p>Në faqen e ueb-it të UBT (https://ubt.edu.al/) gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në shërbim të studentëve, pedagogëve apo të interesuarve të tjerë.</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Informacionet në këtë faqe janë të publikuara vetëm në gjuhën shqipe dhe jo në ndonjë gjuhë tjetër. GVJ u informua që po punohet për të shfaqur informacionet edhe në gjuhën Angleze. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi IV.6 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (“Detajim i Buxhetit FEA”; “Vendim nr. 75, datë 12.2.2018 Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; “Relacion Projekt Buxheti 2017-2019, në funksion të programit të studimit”; “Të dhëna për buxhetin 2018”) rezulton se institucioni harton raport financiar të kostove dhe planin për mbështetje financiare të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, sipas të cilit kosto mesatare për student është 114152.65 lekë. Financimi për student bëhet nga granti i shtetit në bazë të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Plani përmban një raport të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe këto raporte gjenden në Zyrën e Financës. |
| Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | Bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (“Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit”; “Plani për mbështetje financiare për një cikël të plotë studimi”; “Buxheti i detajuar, UBT 2018”; “Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit (Tabelë përmbledhëse)”; “Buxheti UBT, 2018, përmbledhje”) GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një plan financiar për programin e studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” në përputhje me kërkesat e standardeve ligjore. Ky plan financiar përmban të gjithë zërat që lidhen me realizimin e këtij programi studimi të tilla si: financimi i burimeve njerëzore, i shpenzimeve operative, shpenzimeve për mjediset, teknologjinë, pasurimin e literaturës, grantet apo kontratat e lidhura, etj. |
| Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion (“Rregullore e degës së auditit të brendshëm”; “Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit, plani për mbështetje financiare për një cikël të plotë studimi”; RVB) GVJ konstaton se institucioni i nënshtrohet auditimit çdo vit i cili realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit. Monitorimi i brendshëm i aktivitetit dhe treguesve financiarë kryhet rregullisht nga bordi i administrimit. Zyra e financës harton dhe i paraqet bordit të |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | <p>administrimit raporte periodike që kanë të bëjnë me buxhetin e flukseve monetare për periudhën 6 mujore, 1 vjeçare dhe 3 vjeçare, raporte lidhur me koston për njësi për çdo program studimi të UBT, raporte lidhur me nivelin e regjistrimeve në vite dhe pozitën e institucionit në treg, raporte të pasqyrave financiare vjetore, raporte analizash të treguesve financiarë, analiza krahasimore, etj.</p> <p>Në IAL auditimi i jashtëm kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave. Gjithashtu auditimi kryhet edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).</p> <p>UBT përpilon dhe dokumenton raporte financiare 3 vjeçare në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> | <p>Sipas Statutit të UBT, Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit, me propozim të Senatit akademik ai miraton planin strategjik të zhvillimit të universitetit dhe mbikëqyr zbatimin e tij si dhe miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të universitetit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Bazuar në Raportin Financiar vjetor institucional rezultojnë se financimi i institucionit realizohet në masën mbi 60 % nga qeveria dhe mbi 30% nga të ardhurat e UBTsë. Institucioni ka dëshmuar se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| | |
|--|--|
| <p>Standardi V.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe</p> | <p>Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka hartuar gjithë procedurat e nevojshme që mbulojnë ciklin e studimit nga regjistrimi deri në diplomim. Këto procedura janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë të shprehura qartë në</p> |

| | |
|---|--|
| <p>aktet e veta rregullatore.</p> | <p>dokumentat në vazhdim: “Statuti i UBT”; “Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit”; “Rregullore e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional 2017”; “Rregullore e Departamentit të Matematikës – Informatikës”; “Rregullore e Studimeve Universitare”; “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi”.</p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton mbështetur tek këto dokumenta se procedurat dhe politikat e institucionit garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët që duan të regjistrohen në program, si edhe atyre tashmë të regjistruar dhe vazhdojnë studimet në programin e studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”.</p> |
| <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>GVJ konstaton se në Rregulloren e Brendëshme të FEA, Neni 22 gjenden kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor në këtë fakultet. Gjatë vizitës në institucion u informuam se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” në koordinim me QKA (Qendra e Karrierës dhe Alumni), në mënyrë të përvitshme përgatit paketën e informacionit orientues për aplikantët/maturantët e interesuar për të aplikuar për vijimin e studimeve të tyre. Gjithashtu në këtë Rregullore, Neni 75-81 gjenden procedurat dhe kriteret e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme. Gjithashtu informacionet e mësipërme bëhen të qarta edhe nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”.</p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Kreu III, Neni 14-28; Kreu IV, Neni 40, përmban të gjithë informacionet e nevojshme për metodat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve dhe diplomimit.</p> <p>Të gjitha këto informacione janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga të interesuarit.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> | <p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (“Kriteret e pranimit në Bachelor për FEA”) GVJ konstaton se përcaktohen qartë kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta, të cilat janë “Kriteri i Rëndësisë” dhe “Nota e Lëndës me Zgjedhje” (të shpjeguara më poshtë) për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programin e studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” si dhe në programet e tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Pranimi në programin e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si dhe plotëson:</p> |
| <p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Kriterin e meritës (Nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me VKM). |
| <p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Kriterin e rëndësisë (Koeficient i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në FEA, sipas përcaktimeve të departamenteve) (Tabela “Koeficientët e rëndësisë sipas profileve të shkollave të mesme për FEA). |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Notës së lëndës me zgjedhje në fushën e ekonomisë • Kuotave të paracaktuara nga FEA <p>GVJ u informua se në çdo vit akademik Senati Akademik i UBT, i propozon për miratim ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë kriteret e pranimeve të aplikantëve/ maturanëve për të studiuar në UBT. Këto kritere bëhen gjithashtu publike nëpërmjet portalit U-Albania dhe uebsite-t të UBT.</p> <p>Hartimi i kriterëve bëhet në përputhje me udhëzimet dhe aktet nënligjore të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë. Në Rregulloren e Brendëshme të FEA, Neni 22 kriteret e pranimit janë të përcaktuara qartë dhe nuk paraqesin ndonjë pengesë apo përjashtim të regjistrimit të studentëve të huaj në rast se ata i përmbushin këto kritere.</p> <p>Paketa e informacionit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta të programit të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” përgatitet nga Departamenti i Matematikë - Informatikës, FEA në koordinim me QKA dhe në fillim të çdo viti akademik promovohet pranë shkollave të mesme, në faqen e ueb-it të UBT si dhe në portalin U-Albania, për të qenë në dispozicion të të gjithë të interesuarve.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi V.2 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Kreu III, Neni 14-28 përmban të gjithë informacionet e nevojshme për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu këto informacione gjenden edhe në Rregulloren e Brendëshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi. |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Kreu VI, Neni 46-52 si dhe Rregullorja e Brendëshme e FEA, Neni 75-81 përmbajnë të gjithë informacionet e nevojshme për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Këto informacione janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët nëpërmjet faqes së ueb-it të UBT, apo faqeve të ueb-it të pedagogëve të lëndëve të këtij programi studimi. Informimi i studentëve bëhet edhe në fillim të çdo semestri gjatë seancës së parë të prezantimit me lëndët përkatëse. |
| Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe | Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Kreu V, Neni 36-45 si dhe Rregullorja e Brendëshme e FEA, Neni 25-26 përmbajnë të gjithë informacionet e nevojshme për kriteret dhe |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| diplomimit në programin e studimit. | <p>procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në këtë program studimi. Këto informacione janë të aksesueshme lehtësisht nga studentët.</p> <p>Në mënyrë më specifike Departamenti i Matematikë - Informatikës në FEA përgjegjës për këtë program studimi përgatit dhe informon studentët në lidhje me dokumentin për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogut udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike e deri tek formatimi i punimit (bazuar tek dokumenti “Rregullore e Brendëshme DMI, Aneks 1”), dorëzimi dhe mbrojtja. Bazuar tek dokumenti “Rregullore e Brendëshme FEA, Neni 28”; “Rregullore e Brendëshme DMI, Neni 21”.</p> | | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | <p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se institucioni përpara fillimit të vitit akademik publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Bachelor “Informatikës Biznesi” nëpërmjet formave të ndryshme të publikimit. Këtu mund të përmendim takimet e përvitshme me maturanët për promovimin e programit të studimit dhe prezantimin e kritereve të pranimit të tyre nëpërmjet faqes së ueb-it të UBT, portalit U-Albania, Zyrës së Karrierës pranë FEA, etj.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me pedagogët dhe studentët GVJ u informua se që në fillim të studimeve të tyre studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” nëpërmjet mënyrave dhe formave të ndryshme. Prezantimi i parë bëhet nëpërmjet një takimi që realizohet me drejtuesin e departamentit dhe pedagogët që në fillim të vitit të parë akademik. Informacionin për kurrikulën e programit dhe lëndët përbërëse sipas viteve dhe semestrave studentët e gjejnë gjithashtu në faqen e ueb-it të UBT (kurrikula 331 e studimeve të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Biznesi”). Informacione më të hollësishme në lidhje me programin e studimit, studentët mund të marrin nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Rregullores së FEA-së dhe Statutit të UBT-së.</p> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | <p>Informacionet për modulet, lëndët, veprimtaritë formuese të këtij programi studimit janë të paraqitura qartësisht në dokumentat: “Formati Plani Mësimor IB 2018-2019”; “Kurrikula Informatikë Biznesi 2018-2019”; “Kategorizimi i Lëndëve Informatikë Biznesi”. Studentët kanë mundësi akses në të gjitha këto dokumenta.</p> |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> | <p>Departamenti i Matematikë - Informatikës në FEA, përgjegjës për këtë program studimi i mbështet studentët në orientimin e tyre drejt tregut të punës. Hapi i parë është koordinimi me institucionet dhe bizneset që UBT ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në vitin e tretë. Praktika profesionale zhvillohet përgjatë gjithë semestrit të fundit të vitit të tretë duke ju lehtësuar studentëve kalimin drejt tregut të punës dhe rritjen e potencialeve të punësimit.</p> <p>Gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë aspekt luan edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni, qëllimi kryesor i së cilës është mbështetja dhe orientimi i studentëve lidhur me karrierën e tyre nëpërmjet këshillimit për shkrimin e një CV-je, Letre Motivimi, si të kërkojnë informacion për punësim, etj.</p> <p>Një tjetër mundësi që ju ofrohet studentëve është edhe Panairi i Karrierës që organizohet çdo vit në ambientet e kampusit të UBT në funksion të përafrimit të ofertës dhe kërkesës për punësim.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion si dhe në bisedat me studentët, që institucioni vë në dispozicion informacion të bollshëm në lidhje me organizimin e procesit mësimor, klasat, laboratorët, bibliotekat, etj.</p> <p>Rëndësi të veçantë i jepet informimin të studentëve të vitit të parë për të cilët në javën e parë të fillimit të vitit të parë akademik përgatitet një paketë orientuese informacioni nëpërmjet Zyrës së Karrierës së Studentëve që prezantohet në ambientet e UBT.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë informacion të qartë për infrastrukturën dhe logjistikën nëpërmjet tabelave të orareve, tabelave të sinjalistikës për godinat dhe mjediset e tjera në funksion të zhvillimit të mësimin, etj.</p> <p>Konstatojmë që orientimi për të aksesuar ambientet e kampusit të UBT-së është i mundur edhe në distancë nëpërmjet Google Map.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> | <p>Informacioni në lidhje me programin e studimit ju mundësohet studentëve përmes faqeve personale të ëeb-it të pedagogëve të lëndëve. Këto faqe lidhen direkt me faqen kryesore të ueb-it të UBT. Në këto faqe studentët kanë akses të plotë dhe mund të informohen rreth modulit/lëndës në mënyrë të detajuar rreth krediteve, raportit të orëve, peshës së pikëve të vlerësimit të vazhduar dhe të provimit përfundimtar, përmbajtjes së temave që do të trajtohen përgjatë semestrit, etj.</p> <p>Përsa i përket sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) në UBT ai përmban kryesisht module për lidhjen e studentëve me sekretarinë mësimore, ku ata kanë akses nëpërmjet një llogarie personale për tu informuar për rezultatet e tyre të pjesëshme dhe përfundimtare për lëndët e programit.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në

diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | |
|--|---|---------------|---------------------------------------|---------------|-------------------------|----|------|-------------------------|----|------|-------------------------|----|------|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> | <p>GVJ u informua se statistikat vjetore i mban Sekretaria Mësimore, mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, etj. Kjo zyrë disponon regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.</p> | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Të dhëna statistikore në lidhje me studentët në këtë program studimi gjenden edhe tek Zyra e Informacionit dhe Statistikës, Zyra e Studimeve dhe Studentëve dhe Arkivi i UBT.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion përfaqësues të zyrës së sekretarisë na vunë në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi. Gjithashtu GVJ u njoh me statistikat për numrin e studentëve e të diplomuarve, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit, statistika këto lehtësisht të verifikueshme në regjistrin themeltar. Tabela e mëposhtme përmban numrin e studentëve të regjistruar në vitin e parë në përputhje me kuotat e miratuara të cilat janë plotësuar të gjitha. Në këtë tabelë nuk përfshihen studentët e transferuar (bazuar në dokumentin: “Të dhëna Tabelore përmbledhëse dhe evidenca për studentët e UBT-së”).</p> <table border="1" data-bbox="625 949 1465 1200"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të regjistruar në vit të parë</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti akademik 2017-2018</td> <td>90</td> <td>8.35</td> </tr> <tr> <td>Viti akademik 2018-2019</td> <td>90</td> <td>8.53</td> </tr> <tr> <td>Viti akademik 2019-2020</td> <td>90</td> <td>8.75</td> </tr> </tbody> </table> <p>UBT disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.</p> | Viti akademik | Student të regjistruar në vit të parë | Nota mesatare | Viti akademik 2017-2018 | 90 | 8.35 | Viti akademik 2018-2019 | 90 | 8.53 | Viti akademik 2019-2020 | 90 | 8.75 |
| Viti akademik | Student të regjistruar në vit të parë | Nota mesatare | | | | | | | | | | | |
| Viti akademik 2017-2018 | 90 | 8.35 | | | | | | | | | | | |
| Viti akademik 2018-2019 | 90 | 8.53 | | | | | | | | | | | |
| Viti akademik 2019-2020 | 90 | 8.75 | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> | <p>Të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi i tyre dhe deri në diplomim regjistrohen në procesverbalet e provimeve të cilat së pari ngarkohen në sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit (ESSE3) dhe regjistrohen më pas në regjistrin e notave në “hard copy”.</p> <p>GVJ i shqyrtoi këto informacione gjatë vizitës në institucion në takimin me përfaqësuesit e zyrës së Sekretarisë Mësimore.</p> | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Institucioni disponon sistemin e brendshëm të informacionit (ESSE 3) nëpërmjet të cilit menaxhon të dhënat statistikore të studentëve në lidhje me gjithë veprimtarinë e tyre mësimore që në hyrje deri në dalje në programet e ndryshme të studimit. Në këtë sistem kanë akses studentët në llogaritë e tyre personale, pedagogët sipas moduleve apo lëndëve që drejtojnë si dhe sekretaria. Bazuar tek dokumenti “Rregullore e Brendshme FEA, Neni 23, Neni 86”.</p> <p>I gjithë informacioni në sistem është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar që kanë akses në të.</p> | | | | | | | | | | | | |

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>GVJ u informua se institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve bazuar tek të dhënat që grumbullojnë dhe përpunojnë Zyra e Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve (dokumenti “Raport mbi Analizën e Veprimtarisë Mësimore Viti Akademik 2017-2018, FEA”). Këto të dhëna përfshijnë regjistrimet/aplikimet për vijimin e studimeve në programe të ndryshme të studimit, mesataren e aplikantëve të regjistruar, rezultatet e provimeve, grup moshat e studentëve, shpërndarjen gjeografike të tyre, trajtimin me bursa, studentët e transferuar, evidenca lidhur me studentët e diplomuar, etj.</p> <p>Gjithashtu si burim tjetër informacioni GVJ shqyrtoi edhe librin e diplomave i cili mbante informacione me të dhëna për vitin e hyrjes, të mbarimit, fakultetin, degën, numrin e diplomës, numrin e regjistrit, datën e lëshimit dhe firmën e studentit.</p> <p>GVJ u informua se Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS) mban evidenca rreth studentëve në fazën e përfundimit të studimeve dhe në bashkëpunim me QKA realizon studimin lidhur me gjurmimin e studentëve në tregun e punës. QKA gjeneron raporte lidhur me ecurinë e studentëve në tregun e punës, mbas diplomimit të tyre. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua nga përfaqësuesit e zyrës se 65% e studentëve që janë diplomuar në këtë program studimi janë të punësuar. Këto raporte shërbejnë edhe si një referencë për ndërhyrje ose marrje masash sipas nevojave në strukturën apo kurrikulën e programit të studimit.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> | <p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve dhe angazhimi i tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të UBT-së bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe garantohet nëpërmjet statutit të UBT-së.</p> <p>Përmes një procesi të përgjithshëm zgjedhor i cili kryhet çdo katër vjet, studentët marrin pjesë në zgjedhjen e Rektorit të UBT-së dhe Dekanit të fakultetit ku ata bëjnë pjesë. Gjithashtu kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në organet vendimmarrëse të UBT-së, siç është Senati Akademik ku përbëjnë 10% të anëtarësisë së tij. Ata kanë të drejtë të përfaqësohen në Bordin e Administrimit të Universitetit, në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor si dhe në Këshillin e Etikës së UBT-së.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në</p> | <p>Në bazë të Statutit të UBT, Neni 98 studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë të cilët zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Këshillat e</p> |

| | |
|--|---|
| <p>vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të tyre, të tilla si planet dhe programet e studimeve, rregulloren për veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve, etj.</p> <p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se zëri i studentëve dëgjohej jo vetëm nëpërmjet pjesmarrjes në këshilla të ndryshëm por edhe në nivele më të ulëta në diskutime me pedagogët për të zgjidhur problemet dhe shqetësimet e tyre.</p> |
| <p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> | <p>Në hartimin e programeve të studimit merren në konsideratë gjithë rekomandimet për ngarkesën akademike të studentëve në auditor dhe mësim jashtë auditorit sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Për këtë arsye është vendosur edhe një template si për programet studimore, ashtu edhe për organizimin e moduleve ku janë të vendosura qartë ngarkesat përkatëse në orë sipas krediteve. Programi i vitit të parë është ndërtuar me lëndët bazë që ti japë mundësi studentëve të transferohen midis degëve dhe profileve nëse dëshirojnë.</p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Kreu VI, Neni 46-52 si dhe Rregullorja e Brendëshme e FEA, Neni 75-81 përmbajnë të gjithë informacionet e nevojshme për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> | <p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në proceset e hartimit dhe përmirësimin të programeve nëpërmjet këshillave studentorë, veprimtaria e të cilëve garantohet nëpërmjet Statutit të UBT-s. Gjithashtu GVJ u informua gjatë vizitës në institucion se ndryshimet vijnë edhe si rezultat i propozimeve që studentët sjellin pas zhvillimit të praktikave profesionale.</p> <p>Një tjetër mundësi për të shprehur sugjerimet apo kërkesat e tyre në lidhje me programet dhe procesin mësimor studentët e kanë gjatë zhvillimit të anketave që realizohen në javën e fundit të çdo semestri. Rezultatet e tyre përpunohen dhe raporti final analizohet në nivel departamenti dhe dekanati.</p> |
| <p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Studentëve ju jepet mundësia të japin mendim për zhvillimin e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe të ankimojnë rezultatin e marrë apo të rishikojnë fletoren e provimit. Procedurat e ankimimit janë të paraqitura qartë në dokumentin “Rregullore e Brendëshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Neni 73”; “Rregullore e Brendëshme e Departamentit të Matematikë – Informatikës, Neni 42”.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët e këtij programi studimi GVJ u informua që studentët marrin vlerësimin për provimin e kryer nga sistemi 10 ditë pas përfundimit të provimit dhe kanë të drejtë ankimimi brenda 2 ditësh, kjo e mbështetur në dokumentin “Rregullore e Brendëshme e Departamentit të Matematikë – Informatikës, Neni 40” . Gjatë diskutimit me studentët GVJ u informua që sipas mendimit të tyre procesi i vlerësimit të dijeve është transparent dhe i barabartë për të gjithë. Nëse studenti gjykon se ndaj tij ka pasur shkelje procedurjale në provim apo vlerësim atëherë ai bën ankesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit, i cili shqyrton rastin në bazë të Nenit 42 të “Rregullores së</p> |

| | | | | |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Brendëshme të Departamentit të Matematikë – Informatikës” deri në zgjidhjen e problemit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.6
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar (Rregullore e Brendëshme FEA, Neni 102) GVJ konstatoi se institucioni ka ndërtuar procedura e njësi të posaçme si dhe një sistem në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve (dokumentat: “Organigrama e UBT dhe FEA”; “Rregullore DZHKKVI & DITNJ, Neni 15”). |
| Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | GVJ u takua me përfaqësues të Sektorit të Mësimit, Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional në varësi të të cilit është Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) si dhe Sektorit të Informacionit dhe Transferimit të Njohurive nga e cila varet Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA). |
| Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | GVJ u informua se QKA funksionon në rang universiteti dhe në varësi të saj janë pesë Zyrat e Karrierës së Studentëve (ZKS) që funksionojnë në çdo fakultet (dokumenti: “Organigrama e UBT dhe FEA”). QKA nëpërmjet ZKS mbështet zhvillimin e karrierës së studentëve që në momentet e fillimeve të studimeve e deri mbas daljes në tregun e punës si edhe afrimi i tyre në rolin e Alumni UBT. QKA dhe ZKS ofrojnë informacione për zhvillimin e praktikave profesionale, praktikave mësimore, punësimin, internshipe, studime jashtë vendit, shkëmbime me universitetet partnere të UBT, etj. Gjithashtu QKA dhe ZKS ofrojnë shërbime lidhur me këshillimin e karrierës, përmirësimin e përpilimit të një CV-je dhe letre motivimi, organizojnë Panairin e Karrierës, ndërmjetësim për punësim dhe internshipe, krijojnë skedën e punësimit, anëtarësimin në ALUMNI etj (“Rregullore DZHKKVI & DITNJ, Kreu X”). GVJ u informua që nëpërmjet Projektit GRADUA i cili financohet nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, do të bëhen trajnime për punonjësit e e QKA dhe ZKS. Projekti do të mbështesë universitetet shqiptare duke krijuar një model të integruar kërkesë-ofertë të bazuar mbi të dhënat e databazës së të diplomuarve. Projekti synon të krijojë në Shqipëri një platformë inovative të bazuar në teknologjinë e informacionit për ndjekjen e të diplomuarve në lidhje me punësimin e tyre (dokumenti “Raportim Projekti GRADUA Erasmus+”). Të gjitha këto njësi janë të koordinuara në një sistem i cili ndihmon studentët gjatë procesit mësimor dhe për fillimin e karrierës së tyre |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | profesionale. | | | |
| Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | <p>GVJ u informua se Qendra e Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim edhe me departamentet përkatëse përgjegjëse për programet e ndryshme të studimit në UBT realizojnë gjurmimin e studentëve të UBT në tregun e punës, duke realizuar një pyetsor me ta pas një viti nga diplomimi i tyre. Të dhënat analizohen me qëllimin për të nxjerë në pah kryesisht vlefshmërinë e diplomës së UBT në treg, përputhjen e profileve të punës që ofron tregun me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, sigurisht numrin e të punësuarve pas diplomimit, etj (dokumentat: “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve, Raport Performanca e QKA_2018”).</p> <p>Pas analizës së të dhënave hartohet një raport i cili i vihet në dispozicion Rektorit të UBT, si edhe çdo drejtuesi të njësive bazë (dokumenti: “Rregullore DZHKKVI & DITNJ, Neni 41”).</p> <p>Një hallkë shumë e rëndësishme drejt punësimit për studentët e UBT është edhe organizimi i përvitshëm i Panairit të Karrierës nga QKA. GVJ u informua se rezulton që rreth 250 studentë punësohen gjatë ditëve të panairit (dokumentat: “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve, Raport Performanca e QKA_2018”).</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| | |
|--|---|
| Standardi VI.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | <p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (“Rregullorja e Studimeve UBT, Dhjetor-2018”; “Statuti i UBT, Neni 16”; “Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, Neni 12”) si dhe nga takimet me përgaqsues të Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI), GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional si pjesë e DZHKKVI, nëpërmjet politikave të saj (bazuar tek dokumenti</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>“Rregullore DZHKKVI & DITNJ 2017”) synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e vazhdueshme të cilësisë së drejtimit të UBT nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore dhe institucionalizimit të praktikave më të mira; • Rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies; • Zhvillimin e një sistemi cilësie për veprim të ndërgjegjshëm, të përputhshëm dhe vazhdimisht të programuar për të përmirësuar performancën akademike dhe administrative. |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në UBT mbështetet në veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional e cila është nën varësinë e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (bazuar tek dokumentat: “Statuti i UBT, Neni 69”, “Rregullorja e Studimeve Universitare, Neni 90”).</p> <p>Pranë çdo fakulteti pjesë e këtij sistemi janë Komisionet e Përherëshme të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Këto komisione kanë në përbërjen e tyre katër anëtarë përfaqësues të personelit akademik dhe një anëtar përfaqësues të studentëve.</p> <p>GVJ është i mendimit se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UBT është funksionale dhe e kryen veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin e UBT. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që ajo ka në fokus të veçantë evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, organizimin dhe ndjekjen e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi, orientimin dhe udhëheqjen metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm GVJ konstaton se GVB është ngritur në përputhje me Statutin e UBT, dhe ka hartuar Raportin e Vetvlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në fakte të mbështetura mbi dokumentat që i janë vënë në dispozicion edhe GVJ.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> | <p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr 11, datë 07. 04. 2017, “Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, është vendosur Akreditimi Institucional i UBT, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit Institucional është 06/04/2021.</p> <p>Në bazë të dokumentit “Rregullore e Studimeve Universitare, Neni 91” UBT realizon Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë përmes vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe</p> |

| | | | | |
|---|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| | <p>procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është hapur me Urdhër Nr. 208, datë 31. 05. 2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë UBT ka hartuar politika dhe procedura periodike që synojnë përmirësimin e programeve të studimit që ofron. Në bazë të dokumentave: “Rregullore e Studimeve Universitare, Neni 92”; “Manuali i cilësisë Pjesa V”, fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i fakultetit aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces.</p> <p>Gjithashtu gjatë takimit me pedagogët dhe përgjegjësin e departamentit GVJ u informua se syllabuset e lëndëve përmirësohen çdo fillim viti akademik, mund të realizohen përditësime të literaturës apo edhe të përmbytjes deri në masën 20%, të justifikuara kundrejt argumentave mbështetës në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> | <p>Bazuar në dokumentat e vënë në dispozicion (“Rregullore e DZHKKVI & DITNJ 2017, Neni 9”; “Statuti i UBT”) si dhe gjatë takimi me përfaqësues të Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, GVJ konstatoi se nën varësinë e kësaj dege funksionojnë njësi të posaçme që monitorojnë dhe punojnë për rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Këto njësi janë Zyra e Mësimit dhe Kurrikulave dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. GVJ konstaton që këto njësi janë funksionale dhe i kanë kryer detyrat në përputhje me rregulloren. Rezultatet e punës së tyre reflektohen në prodhimin e të dhënave që kanë shërbyer për hartimin e: “Raportit mbi Analizën e Veprimtarisë Mësimore UBT, 2017 – 2018”; “Raportit mbi Analizën e Veprimtarisë Mësimore FEA, 2017 – 2018”; “Raportit mbi Analizën e Veprimtarisë Mësimore DMI, 2017 – 2018”; “Relacionit mbi përmirësimet e kurrikulave të FEA-s, Nr. 266 Prot”.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e</p> | <p>Gjatë takimit me pedagogoet, Përgjegjësin e Departamentit të Matematikë – Informatikës dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, GVJ u informua se programet e studimit të ciklit të parë</p> |

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> | <p>shqyrtohen periodikisht në mënyrë që ti përshtaten kërkesave të tregut, sidomos në rastin e Informatikës së Biznesit.</p> <p>Pedagogët kanë të drejtë të bëjnë ndryshime të vogla deri në masën 20% në një vit akademik, kurse për ndryshime më të mëdha institucioni përdor procedura më standard dhe të dokumentuara. Procedura për ndryshimin e kurrikulës fillon me propozimin nga departamenti që ofron programin përkatës të studimit, i cili kërkon miratimin e fakultetit. Fakulteti pasi miraton kurrikulën e re, të propozuar nga departamenti, e dërgon për miratim tek Zyra e Mesimit dhe Kurrikulave që është nën varësinë e rektoratit. Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të RVB, GVJ u njoh me dokumenta të cilat paraqesin këto procedura formale të ndryshimeve të propozuara (“Relacion mbi përmirësimet e kurrikulave të FEA-s, Nr. 266 Prot”). Ndryshime të rëndësishme të kurrikulës së ciklit të parë të studimeve bachelor janë bërë në fillim të vitit akademik 2017 – 2018, ku përveç të tjerash është vendosur zgjatja e praktikës profesionale në një semestër të plotë dhe pesë semestra pjesa e mësimit.</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>Në dokumentin “Rregullore e DZHKKVI & DITNJ Kreu VI” janë parashikuar statusi dhe veprimtaria e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, ku ndër të tjera kjo zyrë merret me përgatitjen e standardeve për hartimin e dokumentacionit që rregullon realizimin e procesit mësimor në nivel universiteti si dhe përgatit formatet standarde për sondazhet studentore, dhe të stafit.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>Vlerësimi i procesit mësimor bëhet nëpërmjet pyetsorëve formati i të cilave përcaktohet në dokumentin “Manuali i Cilësisë, Pyetsor për Vlerësimin e Procesit Mësimor nga Studentët”. Vlerësimi i performancës së pedagogëve bëhet nëpërmjet formularëve për “Vlerësimin e Performancës”; “Analizën e Veprimtarisë Mësimore”, “Analizën e Veprimtarisë Kërkimore”.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> | <p>Institucioni analizon dhe vlerëson rezultatet e marra nga pyetsorët e studentëve dhe formularët e analizës së performancës së pedagogëve, ndërton raporte vjetore dhe reflekton për zgjidhjen e problematikave të evidentuara. Rezultatet ju bëhen të njohura të gjitha autoriteteve drejtuese në rang fakulteti dhe universiteti si dhe pedagogëve. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që në bazë të raporteve të vlerësimit për performancën e pedagogëve janë marrë edhe masa për pezullime nga puna në rast kur janë konstatuar shkelje të rënda. Në këto raporte janë të paraqitura qartë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive, nëpërmjet rekomandimeve dhe propozimeve për ndryshime të mundëshme (dokumenti “Plani i Masave për Vitin 2018 – 2020”). GVJ u njoh me to nëpërmjet dokumentave të paraqitura dhe takimeve me drejtuesit dhe pedagogët (“Raport mbi Analizën e Veprimtarisë Mësimore Viti Akademik 2017-2018, FEA”; “Analiza e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit për Vitin 2018”).</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| Standardi VI.3 | |
|--|---|
| Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Në bazë të Rregullores së Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Degës së Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ) Neni 3, përcaktohet që degët përbërëse të këtij organizmi ndjekin problemet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor, vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucioni, si edhe kontrollin dhe harmonizimin e dokumenteve administrative, që rregullojnë zhvillimin normal të procesit mësimor në nivel fakulteti. |
| Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimin, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” kryhet në mënyrë periodike (“Rregullore e Studimeve Universitare, Neni 92”), pyetësorët me studentët zhvillohen çdo semestër, vlerësimi i stafit dhe ai i performancës së mësimdhënies dhe kërkimit realizohet çdo vit akademik. Rezultatet dhe gjetjet e këtyre vlerësimeve analizohen në mbledhjen e fundit të vitit kalendarik dhe miratohen në analizën e punës mësimore e kërkimore të Departamentit të Matematikë – Informatikës. Më pas Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive në bashkëpunim me zëvendës rektorin për mësimin përgatisin në mënyrë të përvitshme analizën e veprimtarisë mësimore të Universitetit dhe ja referojnë atë Senatit Akademik (Dokumentat: “Analiza e Veprimtarisë UBT 2017 - 2018”; “Raport mbi Analizën e Veprimtarisë Mësimore FEA Viti Akademik 2017-2018”; “Analiza e Punës Mësimore DMI”). Për kryerjen e vlerësimin periodik institucioni përdor metoda e instrumente të standardizuara të përcaktuara në dokumentin “Manuali i Cilësisë” të cilat ju vihen në dispozicion studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI) dhe Zyrës së Mësimin dhe Kurrikulave (ZMK). |
| Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimin i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për | Në kuadër të përmirësimin të vazhdueshëm të mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, GVJ u informua gjatë takimit me pedagogët, drejtuesin e departamentit por edhe studentët se institucioni përdor përveç metodave të standardizuara të kontrollit, siç janë pyetësorët e studentëve dhe formularët e vlerësimin për performancën e pedagogëve edhe metoda të drejtpërdrejta si p.sh. kontrole të zhvillimit të orëve të mësimin në auditor sidomos për pedagogët e rinj. Gjithashtu në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies institucioni inkurajon pjesëmarrjen e pedagogëve në aktivitete për trajnimin e tyre dhe transferimit të njohurive. GVJ konstaton që nuk ka evidenca të testimeve lokale apo të standardizuara, rezultateve të arritura në |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| profesionet e rregulluara dhe të tjera. | testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | | | |
| Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Përveç metodave të drejtpërdrejta të kontrollit për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi”, përdoren edhe metoda të tërthorta nëpërmjet intervistave dhe sondazheve, kryesisht të fokusuara tek studentët një vit pas diplomimit të tyre për të vlerësuar përputhshmërinë e programit të studimit me nevojat e tregut të punës dhe shkallën e punësimit të të diplomuarve. Këto realizohen nga Qendra e Karrierës dhe Alumni. UBT ka pjesë të strukturave të saj konsultative edhe bordin e alumnit si një organ konsultativ për përmirësimet kurrikulare dhe jo vetëm (dokumenti “Bordi Alumni”). | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi VI.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e pedagogëve dhe studentëve në përputhje me parashikimet ligjore. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në UBT mbështetet në veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional e cila është nën varësinë e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Pranë çdo fakulteti pjesë e këtij sistemi janë Komisionet e Përherëshme të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Këto komisione kanë në përbërjen e tyre katër anëtarë përfaqësues të personelit akademik dhe një anëtar përfaqësues të studentëve. |
| Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit përcaktohen në dokumentat: “Rregullore mbi Organizimin dhe Funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional”; “Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit”; “Manuali i Cilësisë”. |
| Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” janë përfshirë antarë të personelit akademik të Fakultetit të |

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Ekonomisë dhe Agrobiznesit, të Departamentit të Matematikë – Informatikës si dhe studentë të këtij programi studimi.</p> <p>Anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektur integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Kjo është reflektuar si në realizimin e pyetësorëve të studentëve i cili ruan anonimatit e tyre, edhe në dhënien e rezultateve të sondazheve të cilat kanë qenë gjithmonë në përputhje me rregullat për ruajtjen e privatësisë dhe integritetit akademik.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>GVJ u informua gjatë takimit me drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe Departamentit të Matematikë – Informatikës që për përmirësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi ata përfshijnë edhe ekspertizën e aktorëve vendas ose të huaj, më në zë të biznesit apo të fushës akademike, nëpërmjet leksioneve të hapura apo projekteve të tjera dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel universiteti (Dokumenti “Analiza e punës mësimore për vitin akademik 2017 – 2018, pika 2.12; “Bordi Alumni”).</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>GVJ konstaton se të gjitha dokumentat (“Statuti i UBT-së”; “Rregullorja e Studimeve Universitare të UBT-së”; “Manuali i Cilësisë”; “Rregullore mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional”) në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë transparente dhe të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në zyrat përkatëse të institucionit ose nëpërmjet faqes së Eëb-it të UBT.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit analizohen në të gjitha nivelet e njësive që lidhen me programin e studimit duke filluar në nivel departamenti nëpërmjet Analizës së Veprimtarive Mësimore dhe Kërkimore të DMI, në nivel fakulteti nëpërmjet Analizës së Veprimtarive Mësimore dhe Kërkimore FEA si dhe në raportet periodike të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional në nivel rektorati. Në të gjitha rastet raportet bëhen publike duke ruajtur lirinë dhe etikën akademike.</p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>GVJ konstaton se proceset e vlerësimit të programit të studimit shoqërohen jo vetëm me analizën e raporteve të rezultateve të pyetësorëve apo formularëve të vlerësimit, por edhe me një plan masash të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | evidentuara. Ky konstatim mbështetet në dokumentat e vëna në dispozicion “Plan Masash FEA” (për disa vite akademike) si dhe në takimet që u zhvilluan në institucion. | | | |
| Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | GVJ u informua që institucioni analizon impaktin e masave të marra, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë. Një tregues është Vendimi i Dekanatit i marrë për Miratimin e Propozimeve të Ndryshimeve të Kurrikulave Ekzistuese në Ciklin e Parë të Studimeve me qëllim përmirësimin e tyre dhe përputhjen me kërkesat e tregut. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Për këtë qëllim organizohen edhe veprimtari periodike me qëllim të informimit të studentëve dhe personelit akademik në lidhje me ndryshimet që janë bërë si rrjedhojë e kërkesave dhe rekomandimeve të tyre. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”, “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat për hapjen e programeve të studimit që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kështu, plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit.
2. Programi i studimit gëzon mbështetje të mirë nga strukturat drejtuese.
3. Stafi është i angazhuar në projekte lokale dhe ndërkombëtare duke zhvilluar kështu mekanizma specifike për mbështetjen dhe kualifikimin profesional në funksion të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulës.
4. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit dhe prej këtyre marrëveshjeve ka pasur rezultate konkrete.
5. Nëpërmjet projektit GRADUA, IAL ka arritur të ketë një menaxhim mjaft të mirë të alumnit, pra të të diplomuarve në Informatikë Biznesi, si dhe e përdor këtë platformë dhe për lidhjen e studentëve me tregun e punës.
6. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor.

7. IAL kryen analiza vjetore gjithëpërfshirëse, kryen anketime me studentët për stafin, si dhe me stafin për kushtet e punës dhe për problematika të tjera.
8. Cilësia shumë e mirë e personelit akademik përgjegjës për këtë program studimi, shumica e të cilëve kanë grada shkencore dhe tituj akademik.
9. Mbështetja financiare që institucioni i jep personelit akademik efektiv në pjesmarrjen në konferenca, botimin e artikujve në revista shkencore dhe mbulimin e kostos së tarifës së doktoraturës.
10. Sistemi shumë i mirë dhe funksional i sigurimit të brendshëm të cilësisë i cili e mbështet punën e tij jo vetëm tek procedurat e kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës akademike por edhe tek analizat dhe marrja e masave për përmirësimin e vazhdueshëm.
11. Mundësi shumë të mira për pedagogët dhe studentët për përdorimin e disa platformave të bibliotekave on line.

Pika të dobta:

1. Dokumentet e ndryshme të cilat trajtojnë aspekte të ndryshme të programit të studimit, në aspekte të tilla si objektivat, qëllimet, rezultatet e të nxëniet, pozicionet e punës pas diplomimit për studentët e programit të studimit “Informatikë Biznesi”, janë përfshirë në mënyrë jo të detajuar.
2. Konteksti agrokulturor mungon në përgjithësi. Lëndët e kësaj disipline janë të pakta, si dhe në brendësi të lëndëve të tjera nga Ekonomia apo Informatika nuk ka integrim me drejtime të ndryshme të agroindustrisë (ndërkohë që kjo mund të ishte një pikë mjaft e fortë e programit të studimit). Kjo mungesë vërehet dhe tek programet lëndore, apo tematikat e përzgjedhura nga studentët dhe stafi për diploma.
3. Në kurrikulën e programit të studimit nuk ka një lëndë që instruktoren studentët për kërkimin shkencor, shkrimin akademik, apo zhvillimin e mendimit kritik, esenciale këto për realizimin e kërkimit shkencor, shkrimit të punimeve, hartimit të temës së diplomës.
4. Struktura e mësimit të programit të studimit në përgjithësi është mjaft e mirë, por ka nevojë të rishikohen shpërndarjet e lëndëve, ngarkesa mësimore për semestër, rrjedha logjike që ndjekin lëndët si dhe emërtimet e disa prej tyre (siç është sugjeruar në Standartin II. 4, Kriteri 2).
5. Literaturat në programet lëndore janë në përgjithësi më të vjetra se 5 vite.
6. Stafi në përgjithësi është i ri dhe mjaft i përgatitur, por ngarkesa mësimore e tyre është shumë e lartë, mbi normën e lejuar.
7. IAL nuk ka një platformë për kontrollin e plagjiaturës.

Rekomandime:

1. Të prezantohet informacioni i faqes ueb të universitetit edhe në gjuhë të huaj.
2. Të rishihet Rregullorja e brendshme e departamentit, Rregullorja e programit të mësimit, Struktura mësimore e programit të mësimit, Suplementi i diplomës, apo dhe dokumentet të tjerë në të cilët shpjegohen: qëllimi, objektivat, kurrikula, profesionet e studentëve, në mënyrë të tillë që të jenë në një linjë. Procesi të bëhet nën kujdesin e drejtuesve dhe zyrës juridike të IAL, në mënyrë që të evitohen paqartësitë e mundshme, apo interpretimet e përmendura në këtë dokument.

3. Të cilësohet konteksti agrokulturor, i cili përmendet në disa prej dokumentave, por që konkretisht në kurrikul mungon në përgjithësi. Departamenti të marrë një vendim të qartë në lidhje me përfshirjen e këtij konteksti dhe të veprjës në bazë të këtij vendimi, nëse do përfshihet, apo do mbetet ekonomik i pastër. Ne rekomandojmë fort që konteksti të mbahet, duke ruajtur dhe strukturën mësimore që programi ka, por në programet lëndore të përfshihen tema të caktuarra implementuese, ose raste studimi, detyra kursi, projekte në kontekstin e ekonomisë dhe agroindustrisë paralelisht. Gjithashtu, dy lëndët nga agroindustria që ofrohen, nuk janë të kontekstualizuara me informatikën. Një arsye tjetër pse rekomandojmë këtë pikë, është edhe për perspektivën shumë të suksesshme që do ketë ky drejtim ndërdisiplinar në rajonin tonë, pasi në Europë e më tej janë tashmë prej dekadash, si dhe për përthithjen e projekteve të EU, COST, H2020, etj, ku kjo fushë konsiderohet prioritare (*smart agro, agro digitalization, environment quality measurement*, etj). Gjithashtu, projektet, detyrat, tematikat e përzgjedhura për diploma të jenë të orientuara më tepër nga agroindustria.
4. Rekomandojmë vendosjen e një lënde të tillë si “Shkrm akademik” si dhe zhvendosjen e fokusit drejt kërkimit shkencor dhe financimit të tij nga IAL, nga Alumni, institucionet private me të cilat ka marrëveshje.
5. Në strukturën mësimore të programit të mësimi sugjerojmë të ndiqen rekomandimet e cilësuarra në këtë dokument. Të vendoset sasia e ECTS apo e orëve që konsiderohen si praktikë (p.sh. në tabelën e strukturës fusha e projekteve është e paplotësuar), që saktësohen për çdo lëndë orët në laborator (ushtrimet, projektet) në tabelën e strukturës mësimore. Literaturat në programet lëndore të përditësohen dhe të shkruhen sipas ndonjë prej standarteve të bibliografisë.
6. Sugjerojmë aktivizimin më tepër të stafit të ftuar, në mënyrë që ngarkesa e stafit efektiv të ulet.
7. Meqënëse internacionalizimi është një temë gjithmonë e më tepër në vëmendje të IAL-ve shqiptare, sugjerojmë ofrimin e një grupi lëndësh të kategorisë B në gjuhën angleze.
8. IAL rekomandohet të ngrejë një platformë për mësimin online, sidomos dhe në kushtet në të cilat po kalojmë.
9. IAL rekomandohet të përshtasë një platformë për kontrollin e plagjiaturës. Ose, departamenti rekomandohet të kërkojë për mjete, të cilat ofrohen falas online.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Business Informatics", "Agricultural University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The study program is designed in accordance with the requirements for the opening of study programs that affect the economic development of the country. Thus, it meets the needs of the labor market, in line with the strategic goals of local and national economic development in the direction of Information Technology.
2. The study program is well-supported from the governing structures.
3. The staff is engaged in local and international projects thus developing specific mechanisms for professional support and qualification in function of modern teaching methods and curriculum improvement.
4. The institution has signed cooperation agreements in terms of academic and professional cooperation inside and outside the country and from these agreements there have been concrete results.
5. Through the GRADUA project, the HEI has managed to have a very good management of alumni, i.e. graduates in Business Informatics, and uses this platform to connect students with the labor market.
6. Appropriate facilities and modern didactic infrastructure available to the study program provides the necessary modern spaces and conditions for the learning process.
7. HEI conducts comprehensive annual analyzes, conducts surveys with students on staff, as well as staff on working conditions and other issues.
8. Very good quality of academic staff responsible for this study program, most of whom have scientific degrees and academic titles.
9. The financial support that the institution provides to the effective academic staff in attending conferences, publishing articles in scientific journals and covering the cost of the doctoral fee.
10. Very good and functional internal quality assurance system which supports its work not only in the procedures of control and monitoring of the quality of teaching and academic performance but also in the analysis and taking measures for continuous improvement.
11. Very good opportunities for professors and students to use some online library platforms.

Weaknesses:

1. Various documents which deal with different aspects of the study program, in aspects such as objectives, goals, learning outcomes, job positions after graduation for students of the study program "Business Informatics", are included in a not detailed way.
2. The agricultural context is generally absent. The courses of this discipline are few, as well as inside other courses from Economics or Informatics there is no integration with different directions of agro-industry (while this could be a very strong point of the study program). This lack is also noticed in the subject programs, or the topics selected by the students and the staff for diplomas.
3. In the curriculum of the study program there is no subject that instructs students for scientific research, academic writing, or the development of critical thinking, essential for the realization of scientific research, class projects, drafting the diploma thesis.

4. The teaching structure of the study program is generally quite good, but there is a need to review the course distributions, the teaching load per semester, the logical flow that the courses follow and the names of some of them (as suggested in Standard II. 4, Criterion 2).
5. Literature in subjects' syllabi is generally older than 5 years.
6. The staff is generally young and well prepared, but their teaching load is very high, above the allowed norm.
7. The HEI does not have a platform for plagiarism control.

Recommendations:

1. To present the information of the university website in foreign languages.
2. To review the internal Regulations of the department, the Regulation of the curriculum, the teaching structure of the curriculum, the diploma supplement, or other documents which explain: the purpose, objectives, curriculum, student professions, in order to such that they are in line. The process should be done under the care of the leaders and the legal office of the HEI, in order to avoid possible ambiguities or interpretations mentioned in this document.
3. Qualify the agro-cultural context, which is mentioned in some of the documents, but which specifically in the curriculum is generally missing. The Department should make a clear decision regarding the inclusion of this context and act on this decision, whether it will be included, or will remain Economy only. We strongly recommend that the context be maintained, while preserving the teaching structure that the program has, but that subject programs include certain implementation topics, or case studies, course assignments, projects in the context of economics and agro-industry in parallel. Also, the two courses from the agro-industry that are offered are not contextualized with informatics. Another reason why we recommend this point, is for the very successful perspective that this interdisciplinary direction will have in our region, as in Europe and beyond they have been for decades, as well as for the absorption of EU projects, COST, H2020, etc. , where this field is considered a priority (smart agro, agro digitalization, environment quality measurement, etc.). Also, the projects, tasks, topics selected for diplomas should be more oriented towards agro-industry.
4. We recommend the establishment of a subject such as "Academic writing" as well as the shift of focus towards scientific research and its funding by HEIs, Alumni, private institutions with which it has agreements.
5. In the teaching structure of the curriculum we suggest to follow the recommendations set out in this document. Set the amount of ECTS or hours that are considered as practice (eg in the structure table the project field is incomplete), which specify for each subject the hours in the laboratory (exercises, projects) in the table of the teaching structure. Literature in subject programs to be updated and written according to any of the bibliography standards.
6. We suggest activating more guest (invited) staff, so that the workload of effective staff is reduced.
7. Since internationalization is a topic increasingly in the attention of Albanian HEIs, we suggest offering a group of category B courses in English.
8. HEIs are recommended to set up a platform for online learning, especially in the conditions in which we are now.
9. The HEI is recommended to adapt a platform for plagiarism control. Or, the department is recommended to search for tools, which are offered for free online.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |